



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në subjektin Bashkia Elbasan

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI “AUDITIMIN FINANCIAR”

BASHKIA ELBASAN

Tiranë, mars 2026

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit	7
II. HYRJA.....	8
OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.....	9
1. Objektivat dhe qëllimi.....	9
2. Identifikimi i çështjes.....	9
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	9
4. Përgjegjësitë e audituesve.....	10
5. Kriteret e vlerësimit	11
6. Standardet e auditimit	11
7. Metodatat e auditimit	11
8. Dokumentimi i auditimit.....	12
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	13
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Elbasan”.....	13
2. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.....	13
IV. REKOMANDIME	69

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Bashkia Elbasan, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Bashkia Elbasan përbëhet nga 13 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 116 fshatra e cila është një nga më të mëdhatë në Shqipëri, si dhe një nga bashkitë më komplekse për t’u administruar. Qyteti i Elbasanit, me rreth 80 mijë banorë, ka aktualisht rreth 60% të popullsisë së bashkisë ndërsa pjesa tjetër është e ndarë përkatësisht në njësitë administrative, disa prej të cilave gjenden në terrene të thyera malore. Bashkia e re ka në territorin e saj një pjesë të madhe të industrisë së rëndë të Shqipërisë, përfshirë fabrikën e çelikut, atë të çimentos, ferrokromit, etj.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, nenit 50 “Auditi i jashtëm”, pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”.

Ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Elbasan si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Elbasan për periudhën e aktivitetit 2024 qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për

ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 106,937 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve. *Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.*

e. Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Në raportin e auditimit janë formuluar 16 gjetje dhe 19 rekomandime për masa organizative dhe 1 gjetje dhe 1 rekomandim për të ardhura të munguara në shumën **82,739 mijë** lekë.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- Nga auditimi i të dhënave të pasqyruara në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrës së konsoliduar u konstatua që llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar” është paraqitur në vlerën 489,849,456 lekë ndërsa sipas akt rakordimeve me thesarin për të ardhurat e trashëguara të bashkisë qendër dhe njërive shpenzuese u konstatua që të ardhurat e trashëguara janë në vlerën 457,784,864 lekë ose pasqyruar më shumë në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrës së konsoliduar për vlerën 32,064,592 lekë.

- Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës së pozicionit financiar sipas pasqyrës së konsoliduar me të dhënat e llogarive sipas njërive shpenzuese u konstatua që llogaria 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë” dhe llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime” është në vlerën 3,488,500 lekë. Llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” është në vlerën 1,203,393,053 lekë . Llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime” nuk kuadron me kundër partinë e saj llogarinë 468 “Debitor të ndryshëm” për vlerën 1,199,904,553 lekë (1,203,393,053 lekë -3,488,500 lekë). Llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime” është nënvlerësuar në paraqitjen e saj në pozicionin financiar të pasqyrës të konsoliduar për vlerën 1,199,904,553 lekë.

- Nga auditimi i të dhënave të llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” sipas pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduar u konstatua se, 14 projekte në vlerën 41,908,063 lekë (kosto historike) që janë të përfshirë në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, janë të pa analizuar sipas investimeve që u përkasin dhe për 45 projekte në vlerën 127,030,496 lekë nuk ka informacion në lidhje me përfundimin e objekteve.

- Nga auditimi mbi saktësinë e Llogarisë 210 “Toka, troje terrene” rezulton se kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2024.

Nga analiza në lidhje me në këtë llogari janë të evidentuar vetëm për një objekt është përcaktuar sipërfaqja dhe konkretisht, “Tokë varreza publike në sipërfaqen 6130 m2 në vlerën 4,069,958 lekë”. Kjo llogari në 37 raste në vlerën 543,609,925 lekë përbëhet nga toka troje e terrene që janë kryesisht shpronësime që janë të paraqitura vetëm në vlerën e shpronësimit, të pa analizuar sipas sipërfaqeve të tyre dhe në katër raste në vlerën 60,835,633 lekë, janë të pa analizuar edhe për llojin e shpronësimit. Nga verifikimi dhe analiza e Llogarisë. 210 “Toka, troje, terrene”, konstatohet se nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të; a) trojeve nën objekt për ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në Nj. A, etj, sipas regjistrimit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”; b)-truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë; c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Elbasan, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej

bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

- Në inventarin e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” rezultojnë 33 objekte në vlerën 516,441,467 lekë të cilat janë asete të ujësjellësit. Nga auditimi i dokumentacionit dhe nga të dhënat e vena në dispozicion konstatohet se, për 78 objekte pasqyrimi në llogarinë 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*” është bërë në vlerën zero lekë.

- Nga auditimi i pasqyrës së performancës së pasqyrave të konsoliduar të Bashkisë Elbasan u konstatua që në llogarinë 650 “*Interesa për bono thesarit dhe kredi direkte*” janë pasqyruar pagesa e principalit të kredisë për njësinë shpenzuese Bashkia Elbasan për vlerën 50,572,025 lekë që nuk duheshin pasqyruar si shpenzime, pasi pagesa e principalit të kredisë nuk regjistrohet si shpenzim. Pasqyrimi në shpenzime i vlerës 50,572,025 lekë ka pakësuar llogarinë 85 “*Rezultatin i veprimtarisë ushtrimore*” për vitin 2024 në vlerën 50,572,025 lekë.

- Nga auditimi i pasqyrimin të të ardhurave dhe shpenzimeve në pasqyrën e performancës financiare të bilancit të konsoliduar u konstatua që janë paraqitur të ardhura në vlerën 6,559,439,880 dhe duheshin paraqitur në vlerën 5,248,017,923 lekë ose janë paraqitur në vlerën 1,311,421,957 lekë të ardhura më shumë. Shpenzime janë paraqitur në vlerën 6,171,047,024 lekë dhe duheshin paraqitur në vlerën 4,797,203,195 lekë ose në vlerën 1,373,843,829 lekë më pak. Llogaria 85 “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore/ Teprica e periudhës*” duhej paraqitur në vlerën 450,814,728 lekë dhe është paraqitur 388,392,856 lekë dhe është nënvlerësuar për vlerën 62,421,872 lekë.

-Nga auditimi i të dhënave që përmban llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” u konstatua se nuk janë kontabilizuar në fund të vitit 2024 debitorët për gjokat e IMTV-së dhe nuk janë pasqyruar në kontabilitet detyrimet që kanë 21 subjekte në vlerën 52,656,555 lekë, nuk janë kontabilizuar debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 17,714,436 lekë dhe nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve nga kontratat e qirasë të fondit pyjor kullosorë për katër subjekte në vlerën 12,368,615 lekë.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan së bashku me njësitë e varësisë të marrin masa të saktësojnë llogarinë 520 “*Disponibilitete në Thesar*” për diferencën në vlerën 32,064,592 lekë të paraqitur më shumë se akt rakordimi me thesarin dhe ta paraqesë saktë atë në pasqyrën e pozicionit financiar. Gjithashtu Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan së bashku me njësitë e varësisë të marrin masa të saktësojnë llogarinë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” duke kryer rakordimin përkatës me thesarin për këtë llogari.

- Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan së bashku me njësitë e varësisë të marrin masa të saktësojnë llogarinë 4341 “*Operacione me shtetin detyrime*” e cila është nënvlerësuar në paraqitjen e saj në pozicionin financiar të pasqyrës të konsoliduar për vlerën 1,199,904,553 lekë.

- Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masa të identifikojë 14 projektet në vlerën 41,908,063 lekë (kosto historike), se cilit investim i përkasin dhe të saktësojë nëse investimet që u përkasin 45 projektet në vlerën 127,030,496 lekë janë kryer apo jo. Sipas përkatësisë së projekteve, për objektet e përfunduara, të marrë masa për kapitalizmin e tyre në shtesa të llogarive përkatëse të aktiveve.

- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për transferimin e 33 objekteve në vlerën 516,441,467 lekë, të cilat janë asete të ujësjellësit, në “*Sh. R. U. K. E. Sha*” me NIPT M.....V, duke njoftuar Këshillin Bashkiak për procesin e transferimit të këtyre aktiveve.

- Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan të marrë masa të saktësojë mospërputhjen e llogarisë 230-231 “*Investime*” për vlerën 7,844,676 lekë midis pasqyrimin të saj në kontabilitet krahasuar me pasqyrën e Formatit F6 “*Investimet*”.

- Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan të marrë masa të saktësojë llogarinë 650 “Interesa për bono thesarit dhe kredi direkte” në të cilën është pasqyruar pagesa e principalit të kredisë për njësinë shpenzuese Bashkia Elbasan për vlerën 50,572,025 lekë dhe pasqyrimin e saj ne pakësimin e llogarisë 16,17,18 “Huat afat gjata”.

- Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan të marrë masa të saktësojë të ardhurat dhe shpenzimet e raportuara në pasqyrën e performancës financiare të bilancit të konsoliduar, duke pasqyruar saktë të ardhurat dhe shpenzimet korente të vitit ushtrimor për të shmangur dublimin e tyre dhe pasqyrimin e drejtë të llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore/ Teprica e periudhës”.

- Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në bashkëpunim me Sektorin e Financës në njësinë shpenzuese ASHPR të marrë masat të pasqyrojë saktë gjendjen dhe lëvizjet e llogarisë 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore” në pasqyrën statistikore (Formati nr.7/b), si dhe të korrigjoje shumën e amortizimit të llogaritur më tepër në vlerën 14,024,011 lekë.

- Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masa të kontabilizojë në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” debitorët e pa pasqyruar në kontabilitet.

Debitorët nga kontrata e qirasë të fondit pyjor kullosorë ne vlerën totale prej 12,368,615 lekë;

Debitorët për gjobat e IMTV-së që kanë 21 subjekte në vlerën 52.656.555 lekë;

Debitorët për taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 17,714,436 lekë.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Grupi i auditimit të KLSH-së¹, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Elbasan për periudhën ushtrimore 2024, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Elbasan, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**¹, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Baza për opinionin e kualifikuar:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë (ISA

¹ -Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar “ të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 (faqe 54 dhe 60-61), “Një “Opinion i Kualifikuar”, jepet në rastet kur: *audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.*”

700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705- ISSAI 1705).

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 106,937 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2024, si dhe parregullsitë e mëposhtme:

- Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” nuk është pasqyruar saktë për vlerën 32,064,592 lekë;
- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është pasqyruar saktë për debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukture për vlerën 17,714,436 lekë, për gjobat e IMTV-së që kanë 21 subjekte në vlerën 52,656,555 lekë dhe debitorët nga kontrata e qirasë të fondit pyjor kullosorë në vlerën totale prej 12,368,615 lekë. Rrjedhimisht rezultojnë të ardhura të munguara nga mos kontabilizimi i debitorëve në vlerën 82,739,606 lekë;
- Llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime” nuk është pasqyruar saktë, pasi është nënvlerësuar në paraqitjen e saj në pozicionin financiar të pasqyrës të konsoliduar për vlerën 1,199,904,553 lekë;
- Në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” janë paraqitur 14 projekte, në vlerën 41,908,063 lekë (kosto historike) të pa analizuar sipas investimeve që u përkasin dhe për 45 projekte në vlerën 127,030,496 lekë nuk ka informacion në lidhje me përfundimin e objekteve;
- Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” nuk është pasqyruar saktë në fund të vitit 2024 për 33 objekte në vlerën 516,441,467 lekë, pasi këto janë asete të ujësjellësit;
- Regjistri i aktiveve që ka në pronësi, nuk është plotësuar sipas të gjitha kërkesave të formatit të aprovuar nga Ministria e Financave;
- Llogaritë 16,17,18 “Huatë Afat Gjata” sipas pasqyrës së pozicionit financiar të pasqyrës së konsoliduar kanë diferenca në vlerën 110,617,290 lekë krahasuar me të dhënat e thesarit;
- Janë pasqyruar në mënyrë të pa saktë të ardhurat në pasqyrën e performancës së konsoliduar për vlerën 1,311,421,957 lekë (6,559,439,880-5,248,017,923);
- Janë pasqyruar në mënyrë të pa saktë shpenzimet në pasqyrën e performancës së konsoliduar në vlerën 1,373,843,829 lekë (6,171,047,024 lekë - 4,797,203,195 lekë);
- Llogaria 650 “Interesa për bono thesarit dhe kredi direkte” nuk është pasqyruar saktë për vlerën 50,572,025 lekë;
- Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore/ Teprica e periudhës” nuk është pasqyruar saktë për vlerën 134,527,727 lekë (62,421,872 lekë +19,089,830 lekë +50,572,025 lekë + 2,444,000 lekë).

I. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1097/1prot., datë 19.11.2025 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 19.11.2025 deri më datën 18.12.2025, në subjektin Bashkia Elbasan për periudhën 01.01.2024 deri më datën 31.12.2024 u krye auditimi “Auditim financiar në Bashkinë Elbasan” nga grupi i auditimit me përbërje:

1. L.Z., Përgjegjës Grupi;
2. L. Gj., anëtar;
3. E. S., anëtar.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në këtë fazë të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i Auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Elbasan.

2. Identifikimi i çështjes.

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bazë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Elbasan, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Elbasan.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Kryetari i Bashkisë Elbasan (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Buxhetit dhe Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili

garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Elbasan, bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësive së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Elbasan në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit. Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe Alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Elbasan është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, paragrafi 44- 51.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësisve që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financiare nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

6. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”; etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar të KLSH-së; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodatat e auditimit

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u

krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit.

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme.

Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u përgatit ky Raport Auditimi Përfundimtar. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për

përgatitjen e tyre.

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Elbasan”

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Elbasanit kufizohet në veri me bashkinë Tiranë, në lindje me bashkinë Librazhd, në jug-lindje me bashkinë Prrenjas, në jug-perëndim me bashkinë Gramsh dhe në perëndim me bashkitë Cërrik dhe Peqin.

Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2011, kjo bashki numëron 141,714 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 205,892 banorësh dhe me densitet prej 236.11 banorë për km². Bashkia e Elbasanit ka një sipërfaqe prej 872,03 km².

Të dhëna të tjera: Bashkia Elbasan përbëhet nga 13 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 116 fshatra e cila është një nga më të mëdhatë në Shqipëri, si dhe një nga bashkitë më komplekse për t'u administruar. Qyteti i Elbasanit, me rreth 80 mijë banorë, ka aktualisht rreth 60% të popullsisë së bashkisë ndërsa pjesa tjetër është e ndarë përkatësisht në njësitë administrative, disa prej të cilave gjenden në terrene të thyera malore. Bashkia e re ka në territorin e saj një pjesë të madhe të industrisë së rëndë të Shqipërisë, përfshirë fabrikën e çelikut, atë të çimentos, ferrokromit, etj. Një pjesë e njërive administrative shtrihen përgjatë luginës së Elbasanit, por më shumë se gjysma e ish-komunave gjenden në një seri zonash malore, duke filluar nga Graceni e duke vazhduar me Labinot Mal, Gjinarin e Zavalinën apo edhe ish- komuna Funar. Parku kombëtar i Gjinarit në krahinën historike të Shpatit është i përshtatshëm për turizëm të natyrës dhe të kulturës.

Misioni i Bashkisë Elbasan është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve. duke garantuar vetë-qeverisjes në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Elbasan për periudhën e aktivitetit të vitit 2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe zbatimin e kuadrit rregullator ligjor të raportimit financiar.

2. Auditimi mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

1.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

1.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

1.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

Në zbatim të Pikës nr. 1, të Programit të Auditimit 1097/1.prot., datë 19.11.2025, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël.

- Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare.
 - Dokumentacioni i mbajtur mbi përlllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve.
 - Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.
 - Dokumentacioni i mbajtur mbi realizimin e procesit të inventarizimit.
 - Dokumentacioni i mbajtur për administrimin dhe regjistrimin e aseteve me certifikate pronësie.
 - Të dhënat e thesarit për llogaritë kontabël të aktivitetit, pasivitetit, detyrimeve dhe llogaritë të ardhurave.
- Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:**
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese
- Udhëzim nr.13, datë 18.12.2024 “Për Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2024”
- Udhëzimi nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar.
- Udhëzimi nr.35, datë 29.12.2023 “Për procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njësite e vetëqeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësite të vetëqeverisjes vendore”.
- Udhëzim plotësues nr.1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit për vitin 2024”.

Hartimi i pasqyrave financiare për vitin 2024:

Për vitin 2024, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Pasqyrat statistikore:

- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

- Pasqyrat financiare të konsoliduar Bashkia Elbasan janë të firmosura nga Kryetari i Bashkisë z. K. LL. (Nëpunësi Autorizues) si dhe hartuesi i llogarive znj. A. M. (Nëpunësi zbatues). Pasqyrat financiare të konsoliduar përbëhen nga pasqyrat financiare të Bashkisë Elbasan si dhe të njësiteve shpenzuese në varësi. Të dhënat në lidhje me hartimin, konfirmimin dhe depozitimin e pasqyrave financiare të konsoliduar dhe pasqyrat financiare të Njësiteve Shpenzuese Bashkia Elbasan paraqiten në pasqyrën më poshtë:

Tabela nr. 1: Të dhëna në lidhje me hartimin e pasqyrave financiare.

Nr	Njesia shpenzuese	Titullari i Nj.Shpenz. Nëpunësi autorizues	Shkresa e depozitimit në Degën e Thesarit Elbasan		Hartuesi i PF 2024 (Nëpunësi Zbatues)
			Nr.prot.	Datë	
	Të Konsoliduar	G.LI.	4332	04.09.2025	A. M.
1	Bashkia Elbasan (qendra)	A.B./G. LI.	1637	27.03.2025	A. M.
2	Qendra Artit Elbasan	K. K.	347	25.03.2025	L. S.
3	Agjencia Kultures dhe Turizmit	A. G.	1636	27.03.2025	Bl. L.
4	Qendra Ekonomike e Arsimit	D. C.	247	26.02.2025	F. Q.
5	Njësia Administrata Banesave Sociale Elbasan	E. P.	373	27.03.2025	S. C.
6	Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane	A. L.	148	28.03.2025	L. T.
7	Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale	A. C.	243	25.03.2025	B. D.
8	Qendra Sociale Balashe	E. P.	356	26.03.2025	B. Gj
9	Klubi Shume sportesh Elbasan	A. K.	287	10.03.2025	M. B.
10	Agjencia e Pyjeve, Bujqësisë dhe Mjedisit	Sh.C.	374	27.03.2025	E. D.

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës/përpunoi grupi i auditimit.

Pasqyra financiare e konsoliduar është dërguar në degën e thesarit me shkresën nr.4332. prot., datë 04.09.2025 jashtë afatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar Kreu V “Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore” pika 120.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, arkën, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj., të cilat mbahen dhe përpunohen në format Excel.

Për t’u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara për sa i përket vlefshmërisë për t’u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

-Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor; Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin e rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”

dhe jo me program të veçantë.

- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël.

Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, liste pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (*ose në bazë të të drejtave të konstatuara*), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësishë ekonomike.

Qasja dhe metodologjia e auditimit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruara nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2024 ka marrë në konsideratë vlerën e precizonit 106,937 mijë lekë për shpenzimet dhe 106,263 mijë lekë për të ardhurat.

Bazuar në vlerën e materialitetit të përlllogaritur nga ana e grupit të auditimit u krye verifikimi me zgjedhje për urdhër shpenzimet e periudhës 01.01.2024 deri në 31.12.2024.

Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*” për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; Dokumentet autorizues, Dokumentet vërtetues, Dokumentet e kontabilitetit, etj.

Procesi i inventarizimit:

Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësishë i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Çdo njësi publike duhet të

kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se;

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në zbatim të Urdhrave të Titullarit të Bashkisë dhe Drejtuesve të Njësive Shpenzuese të Bashkisë Elbasan “Për inventarizimin e aktiveve afatgjatë, afatshkurtër e materiale për periudhën viti 2024”, në secilën njësi shpenzuese është ngritur komisioni për të kryer inventarizimin fizik të aktiveve në përdorim, si dhe për të krahasuar gjendjen konkrete të aktiveve me gjendjen kontabël, me anëtarë për Bashkinë Elbasan dhe Njësitë e varësisë që në mënyrë të detajuar janë paraqitur në aneksin 1/51, bashkangjitur këtij raporti auditimi:

Me urdhrin e Titullarit/Drejtuesve të Njësive Shpenzuese të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata”, në secilën njësi shpenzuese është ngritur komisioni përkatës për vlerësimin e aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata. Këto komisione kanë bërë vlerësimin dhe verifikimin e aktiveve afatshkurtra dhe afatgjata të inventarizuara duke hartuar proces-verbalin e vlerësimit.

- Me urdhra të Titullarëve janë ngritur komisionet, objekt i të cilëve është vlerësimi i aktiveve të rezultuara jashtë përdorimit. Në proces verbalet e vlerësimit të komisionit është cilësuar se të gjitha aktivet janë dëmtuar, amortizuar dhe e kanë humbur funksionin.

Vlera e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr. 2: Të dhëna për nxjerrjet jashtë përdorimit.

Lekë

Nr	Njesia shpenzuese	Aktive total dala nga përdorimi	Llogaria 218			Llogaria 215		Llogaria 214		Akt. A.Sh Llog.327
			"Inv. Ekonomik"			Mjete transporti		"Instalime teknike, pajisje"		
			Kosto Hist.	Kosto Hist.	Vl. e mbet.	Kosto Hist.	Vl. e mbet.	Kosto Hist.	Vl. e mbet.	
1	Bashkia Elbasan(qendra)	18,273,229	3,610,107				14,332,285		330,837	
2	Qendra Artit Elbasan	0								
3	Agjencia Kultures dhe Turizmit	0								
4	Qendra Ekonomike e Arsimit	17,678,140	8,158,298				1,987,145		7,532,697	
5	Nj. Ad. Banesave Sociale Elbasan	0								
6	Agjencia e Shërb Publike Urbane	0								
7	Agjencia e Shërb. Publike Rurale	23,047,972	460,077		19,003,625	28,109	366,204		3,218,066	
8	Qendra Sociale Balashe	621,660	621,660							
9	Klubi Shumesportesh Elbasan	1,564,521	240,000	50,332					1,274,189	
10	Agjencia e Pyje,Bujq. dhe Mjedisit	0								
	Totali	61,185,522	13,090,142		19,003,625		16,685,634	0	12,355,789	

Burimi: Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës/përpunoi grupi i auditimit.

Nga auditimi i procedurave të nxjerrjes jashtë përdorimit u konstatua se njësia shpenzuese Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale(ASHPR) ka bërë vlerësimin për aktivet që janë për jashtë përdorimit nga komisioni i ngritur me urdhrin Nr.49, datë 24.10.2024 dhe i përbërë nga K. T., kryetarë dhe anëtarët D. M., A. B., V. B., E. H.. Me urdhrin nr.49/1, datë 08.07.2024 të drejtorit A. C. është ngritur grupi i punës për verifikimin e automjeteve i përbërë nga G. G. Kryetar, dhe anëtarët P. Sh., G. T., A. K. dhe B. B. të cilët me relacionin me nr.530/2.prot., datë 15.11.2024 të konfirmuar nga Drejtori A. C. kanë vlerësuar për jashtë përdorimit 6(gjashtë) mjete të detajuara në tabelën në vijim:

Tabela nr. 3: Të dhëna për mjete e vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit.

Nr	Targa	Sa sia	Vlefte ne Inventar	Amortizimi I llogritur	Viti I Prodhimit	Marka	Nr.Shasise
530/3 dt 15.11.2024	AA651AO	1	1.081.000	1.081.000	1995	Mercedes Benz	Wdb2020I8IA24413I
530/4 dt 15.11.2024	TR8683L	1	930.000	930.000	1990	Volvo	ZB1E6A8LB456314
530/5 dt 15.11.2024		1	407.625	407,625		Traktor	
530/6 dt 15,11,2024	EL1483A	1	9,500,000	9,477,513	1992	Fiat Iveco	YCFC3550I02077558

530/7 dt 15.11.2024	EL0885A	1	1,290,000	1,290,000	1993	Fiat Iveco	YCFC4970002096550
530/8 dt 15.11.2024		1	5,000,000	5,000,000	1993	EË200 Eskavator	FË2002425
530/9 dt 15.11.2024	EL676A	1	795,000	795,000	2005	Shifeng Motokarro	5050303614

Komisioni i vlerësimit me proces verbalet me nr.530/10,datë 02.12.2024, nr.530/11,datë 02.12.2024, nr.530/12,datë 02.12.2024, nr.530/113,datë 02.12.2024 ka bërë vlerësimin për aktive për nxjerrje jashtë përdorimit si në vijim:

- Llog. 214 në vlerën 366,204 lekë.
- Llog. 218 në vlerën 460,077 lekë.
- Llog. 215 në vlerën 19,003,625 lekë.
- Llog. 327 në vlerën 3,218,066 lekë.

Nga ana e sektorit të financës është bërë shkarkimi nga kartelat e llogarive përkatëse bazuar në proces verbalet e komisioneve të vlerësimit.

- Nga auditimi i procedurës së kryer në lidhje me asgjësimin e aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit u konstatua se: Njësia shpenzuese ASHPR, Bashkia Elbasan në kundërshtim pikën 100 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” nuk ka ngritur komisionin për asgjësimin e aktiveve dhe në kundërshtim pikën 96 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është vazhduar praktika për nxjerrjen nga përdorimi sipas relacionit të komisionit të vlerësimit/ seleksionimit.

Për veprimet mësipër mbajnë përgjegjësi Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale z. A. C. dhe përgjegjësja e Financës znj. B. D..

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit:

Nga auditimi rezultoi që mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike, në Bashkinë Elbasan, mbahet në mënyrë manuale, që e bën me risk të lartë për sa i përket sigurisë në saktësinë e informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti pasi përdoret programi Excel për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave kontabël të Njesisë dhe njësive të vartësisë. Drejtorja e Buxhetit dhe Financës dhe njësitë shpenzuese të Bashkisë Elbasan, regjistrimet e veprimeve kontabël, i kryejnë me program Excel dhe jo me “Bartës informatikë”, të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera në këtë mënyrë ndikojnë në mos besueshmërinë dhe riskun që bartin në vetvete këto programe duke qenë të ndryshueshme në çdo kohë, të cilat gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekte. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrigjimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare

Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenin 3, pikat 14 e 15 ku citohen se;

“Dokument kontabël” është dokumenti bazë, dokumenti plotësues dhe regjistrat (librat) kontabël, që përgatiten në letër të shkruar ose në bartës informatikë...

“Bartës informatik” është çdo dokument kontabël i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.”

me nenin 11 ku citohet se;

Qëllimi i pasqyrave financiare. 1. Pasqyrat financiare hartohen në mënyrë të qartë, në përputhje me këtë ligj dhe standardet e aplikueshme të raportimit financiar, si dhe paraqesin me vërtetësi dhe

besueshmëri pozicionin financiar, performancën financiare, ndryshimet në kapital/aktivet neto dhe flukset e mjeteve monetare të njëjësive ekonomike. 2. Pasqyrat financiare në këtë ligj u referohen pasqyrave financiare individuale dhe pasqyrave financiare të konsoliduara.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2024, të pozicionit financiar të Bashkisë Elbasan, formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme. Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2024, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, ato paraqiten si më poshtë:

Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasivet 9,278,879,551 lekë.
Aktivet 10,784,386,422 lekë.
Pasivet 1,505,506,871 lekë.

Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.2024 paraqiten në vlerën 2,166,860,592 dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në vlerën 519,164,405 lekë.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në vlerën 219,752,381 lekë.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në vlerën 1,427,943,806 lekë.

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

Tabela nr.4: Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”.

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Ndryshimi
531	Mjete monetare në Arkë			0
512,56	Mjete monetare në Bankë	15,439,499	66,011,525	- 50,572,026
520	Disponibilitete ne Thesar	489,849,456	416,567,321	73,282,135
50	Letra me vlere			-
532	Vlera te tjera	13,875,450	17,504,750	- 3,629,300

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

- **Llogaria 512 “Mjete monetare ne Banke”** është në vlerën prej 15,439,499 lekë dhe përfaqëson gjendjen e mjeteve monetare në bankë për kredinë e marrë në Bankën Kombëtare Tregtare me nr. kontrate 405c11A141640003. Nga auditimi i pasqyrave individuale të pozicionit financiar u konstatua që llogaria 512 “Mjete monetare në Bankë” është në vlerën prej 15,439,499 lekë dhe i përket Njësisë Shpenzuese Bashkia Elbasan(qendër).

Nga të dhënat e vëna në dispozicion për të ardhurat e trashëguara sipas akt rakordimit me thesarin u konstatua që për kapitujt 01,05,06 shuma është në vlerën 436,000,489 lekë, me një ndryshim në pasqyrim në vlerën 53,848,966 lekë (489,849,456 lekë – 436,000,489 lekë).

Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetin nuk na u vu në dispozicion akt rakordimi i mbajtur me thesarin për llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”

- **Llogaria (520) “Disponibilitete në thesar”**. Nga të dhënat analitike sipas pasqyrave të pozicionit financiar të Bashkisë Elbasan dhe njëjësive shpenzuese rezulton që llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar” në fund të vitit 2024 është pasqyruar në vlerën 489,849,456 lekë që është shuma e gjendjeve analitike të kësaj llogarie sipas njëjësive shpenzuese: Nga auditimi i të dhënave sipas akt rakordimeve shkresore me thesarin sipas njëjësive shpenzuese për të ardhurat e trashëguara u konstatua që ka mospërputhje midis të dhënave për të ardhurat e trashëguara për vitin 2025 me llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar” për vlerën prej 32,064,592 lekë.

Tabela nr.5: Rakordimi i llogarisë 520 “ Disponibilitete ne Thesar ” me thesarain

Nr	Emërtimi i institucionit	Disponibilitete ne Thesar, llogaria 520 sipas pozicionit financiar	Te ardhurat e trashëguara sipas akt rakordimit me thesarain(te ardhurat qe trashëgohen për vitin 2025)	Diferenca
1	Bashkia Elbasan qendër	446,759,542	436,000,489	10,759,053
2	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	8,672,298	8,627,023	45,275
3	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	6,043,880	423,242	5,620,638
4	Agjencia e shërbimeve publike urbane	4,216,900	4,216,900	0
5	Klubi shume sportesh Elbasan	143,776	143,776	0
6	Qendra ekonomike arsimit	20,432,290	4,792,664	15,639,626
7	Qendra sociale balashe		0	0
8	Agjencia e kulturës dhe turizmit	276,400	276,400	0
9	Njësia administrimit banesave sociale	3,303,870	3,303,870	0
10	Qendra artit Elbasan	500	500	0
11	Totali sipas Pasqyrave financiare individuale	489,849,456	457,784,864	32,064,592

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës

Nga të dhënat e vëna në dispozicion për të ardhurat e trashëguara sipas akt rakordimit me thesarain u konstatua që të ardhurat e trashëguara për Bashkinë qendër Elbasan janë në vlerën 436,000,489 lekë me një ndryshim në pasqyrim në pasqyrën e pozicionit financiar prej 10,759,053 lekë (446,759,542–436,000,489).

Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetin nuk na u vu në dispozicion akt rakordimi i mbajtur me thesarain për llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” për bashkinë dhe njësitë e varësisë duke mos dhënë siguri për saktësinë e paraqitjes së kësaj llogarie në pasqyrat financiare të konsoliduar.

Nga auditimi i të dhënave të pasqyrave të pozicionit financiar individuale sipas njësive shpenzuese u konstatua që Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit e ka paraqitur llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar” në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitit 2024 në vlerën 8,672,298 lekë ndërsa sipas akt rakordimit me thesarain u konstatua që të ardhurat e trashëguara për këtë njësi janë në vlerën 8,627,023 lekë me një ndryshim në vlerën 45,275 lekë.

Agjencia e shërbimeve publike Elbasan e ka paraqitur llogarinë 520 “Disponibilitete ne Thesar” në fund të vitit 2024 në vlerën 6,043,880 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar ndërsa sipas akt rakordimit me thesarain u konstatua që të ardhurat e trashëguara për këtë njësi janë në vlerën 8,627,023 lekë me një ndryshim në vlerën 45,275 lekë.

Qendra Ekonomike Arsimit e ka paraqitur llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar” në fund të vitit 2024 në vlerën 20,432,290 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar ndërsa sipas akt rakordimit me thesarain u konstatua që të ardhurat e trashëguara për këtë njësi janë në vlerën 4,792,664 lekë me një ndryshim në vlerën 15,639,626 lekë.

Konkluzion: Nga auditimi i të dhënave të pasqyruara në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrës të konsoliduar u konstatua që llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar” është paraqitur në vlerën 489,849,456 lekë ndërsa sipas akt rakordimeve me thesarain për të ardhurat e trashëguara të bashkisë qendër dhe njësive shpenzuese u konstatua që të ardhurat e trashëguara janë në vlerën 457,784,864 lekë ose janë pasqyruar më shumë në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrës së konsoliduar për vlerën 32,064,592 lekë. Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetin nuk na u vunë në dispozicion akt rakordimi i mbajtur me thesarain për llogarinë 466 “kreditorë në ruajtje” për bashkinë dhe njësitë e varësisë duke mos dhënë siguri për saktësinë e paraqitjen së llogarisë 520 “Disponibilitete ne Thesar” në pasqyrat financiare të konsoliduar.

Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit ka paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitit 2024 në llogarinë 520 “Disponibilitete ne Thesar” më shumë vlerën prej 45,275 lekë.

Agjencia e shërbimeve publike Elbasan ka paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitit 2024 në llogarinë 520 “Disponibilitete ne Thesar” më shumë vlerën prej 5,620,638 lekë.

Qendra Ekonomike e Arsimit ka paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitit 2024 në llogarinë 520 “Disponibilitete ne Thesar” më shumë vlerën prej 15,639,626 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar ,neni 22, pika 3, germa “dh”.

Në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 ‘Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme’ pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39.

“Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 39 ndryshon përmbajtjen, si më poshtë: Këto pasqyra iu dërgohen njësitëve të qeverisjes së përgjithshme të Juridiksionit përkatës të degëve të thesarit për krahasimin e bilancit vërtetues me informacionin financiar të SIFQ, rakorduar gjatë vitit sipas paragrafit 37. Qëllimi kryesor është përgatitja e pasqyrave financiare Individuale për çdo njësi shpenzuese, përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara në nivel njësie publike qendrore ose vendore, së bashku me shënimet shpjeguese, ku analizohet diferenca midis vlerave kontabël të njësitëve dhe vlerave kontabël të SIFQ, veçanërisht diferenca midis zërave të Pasqyrës së Flukseve Monetare prodhuar nga SIFQ dhe zërat e Pasqyrës së Performancës Financiare prodhuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 ”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar pika 50, ku thuhet..... “Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt akordim me thesarin, një kopje e te cilit i bashkëngjitet llogaris vjetore. Ne akt akordim, tepricat duhet te paraqiten të strukturuar sipas natyrës se te ardhurave te trashëguara (te ardhurat e papërdorura, si te çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet”.

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi:

Z. E. D. Nëpunës zbatues Agjencia e Pyjeve, Bujqësisë dhe Mjedisit.

Znj. B. D. Nëpunës zbatues Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale.

Znj: F. Q. Nëpunës zbatues Qendra Ekonomike e Arsimit.

Znj. A. M. Nëpunës zbatues Bashkia Elbasan.

Nga auditimi i të dhënave të pasqyrave të pozicionit financiar individuale sipas njësitëve shpenzuese u konstatua që totali i llogarisë (520) “Disponibilitete në thesar” sipas pasqyrave individuale të njësitëve shpenzuese në fund të vitit 2024 është në shumën 489,849,456 lekë. Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” duhet të ketë kundër parti llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” e cila paraqitet në shumën 53,848,966 lekë dhe llogarinë. 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore/ Teprica e periudhës” e cila paraqitet në shumën 388,392,856 lekë. Për sa më sipër llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” që është në vlerën 489,849,456 lekë nuk përputhet me totalin e llogarisë 466 + 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore/ Teprica e periudhës” që është në vlerën 442,241,822 lekë(388,392,856 lekë + 53,848,966 lekë).

Llogaria (520) “Disponibilitete në thesar” nuk përputhet me shumën e llogarive 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore/ Teprica e periudhës” dhe llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” për vlerën prej 47,607,634 lekë (489,849,456 lekë - 442,241,822 lekë)

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar ,neni 22, pika 3, germa “dh”.

Në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 ‘Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë

9.3.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39.

“Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 39 ndryshon përmbajtjen, si më poshtë: Këto pasqyra iu dërgohen njësitë të qeverisjes së përgjithshme të Juridiksionit përkatës të degëve të thesarit për krahasimin e pasqyrës vërtetues me informacionin financiar të SIFQ, rakorduar gjatë vitit sipas paragrafit 37. Qëllimi kryesor është përgatitja e pasqyrave financiare Individuale për çdo njësi shpenzuese, përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar në nivel njësie publike qendrore ose vendore, së bashku me shënimet shpjeguese, ku analizohet diferenca midis vlerave kontabël të njësitë dhe vlerave kontabël të SIFQ, veçanërisht diferenca midis zërave të Pasqyrës së Flukseve Monetare prodhuar nga SIFQ dhe zërat e Pasqyrës së Performancës Financiare prodhuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :

Znj. A. M. Nëpunës zbatues Bashkia Elbasan

- **Llogaria (532) “Vlera të tjera”** paraqitet në pasqyrat financiare në fund të vitit 2023 në shumën 17,504,750 lekë ndërsa në fund të vitit 2024 në shumën 13,875,450 lekë. Nga auditimi i të dhënave të pasqyrave të pozicionit financiar individuale sipas njësitë shpenzuese paraqitet si në tabelën në vijim.

Tabela nr.6: Rakordimi i llogarisë 532 “Vlera te tjera ” me thesarin/lekë.

Nr	Njësitë Shpenzuese	Vlera te tjera llogaria 532 sipas pozicionit financiar	Vlera te tjera llogaria 532 sipas akt rakordimit
1	Bashkia Elbasan qendër	8,274,600	
2	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	0	
3	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	0	
4	Agjencia e shërbimeve publike urbane	0	
5	Klubi shume sportesh Elbasan	0	
6	Qendra ekonomike arsimit	0	
7	Qendra sociale balashe	0	
8	Agjencia e kulturës dhe turizmit	175,000	
9	Njësia administrimit banesave sociale	0	
10	Qendra artit Elbasan	5,425,850	
11	Totali sipas Pasqyrave financiare	13,875,450	

Burimi: Drejtorja e Buxhetit dhe Financës.

Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit nuk na u vu në dispozicion akt rakordimi i mbajtur me thesarin për llogarinë 532 “Vlera te tjera”.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar ,neni 22, pika 3, germa “dh”.

Në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39.

“Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 39 ndryshon përmbajtjen, si më poshtë: Këto pasqyra iu dërgohen njësitë të qeverisjes së përgjithshme të Juridiksionit përkatës të degëve të thesarit për krahasimin e pasqyrës vërtetues me informacionin financiar të SIFQ, rakorduar gjatë vitit sipas paragrafit 37. Qëllimi kryesor është përgatitja e pasqyrave financiare Individuale për çdo njësi shpenzuese, përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar në nivel njësie publike qendrore ose vendore, së bashku me shënimet shpjeguese, ku analizohet diferenca midis vlerave kontabël të njësitë dhe vlerave kontabël të SIFQ, veçanërisht diferenca midis zërave të Pasqyrës së Flukseve Monetare prodhuar nga SIFQ dhe zërat e Pasqyrës së Performancës Financiare prodhuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :

Znj. A. M. Nepunes zbatues Bashkia Elbasan.

2. Llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2024, paraqiten në vlerën 219,752,381 lekë dhe përbëhen nga; llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 63,795,392 lekë; llogaria 32 “Inventar i imët” në vlerën 155,956,989 lekë.

-Llogaria 31 “Materiale”, në 31.12.2024 është pasqyruar në vlerën 63,795,391 lekë.

Nga auditimi i të dhënave të pasqyrave të pozicionit financiar sipas njësive individuale u konstatua që shuma e llogarisë 31 “Materiale” korrespondon me shumën e pasqyruar në bilancin e konsoliduar dhe është në vlerën 63,795,392 lekë.

-Llogaria 32 “Inventarë i imët”, në 31.12.2024 është pasqyruar në vlerën 155,956,989 lekë.

Nga auditimi i të dhënave të pasqyrave të pozicionit financiar sipas njësive individuale u konstatua që shuma e llogarisë 32 “Inventarë i imët” korrespondon me shumën e pasqyruar në bilancin e konsoliduar dhe është në vlerën 155,956,989 lekë.

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Titullari i Bashkisë Elbasan ka nxjerrë Urdhrat e inventarizimit ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhen nga:

- Llogaria 423, 429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” është pasqyruar në pozicionin financiar të pasqyrës të konsoliduar në vlerën 740,900 dhe nuk ka pasur ndryshime gjatë vitit 2024. Shuma e të dhënave të pozicionit financiar të njësive individuale korrespondon me të dhënat e paraqitura në bilancin e konsoliduar.

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 1,178,076,763 lekë ndërsa në mbyllje të pasqyrës në datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 1,203,393,053 lekë me një rritje në vlerën 25,316,290 lekë. Lëvizja e llogarisë, për periudhën në auditim, paraqitet në pasqyrën në vijim:

Tabela nr.7: Të dhëna për lëvizjen e llog. 468 “Debitorë të ndryshëm”

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”/lekë	
Çelje e vitit 2024	1,178,076,762
Shtesa (D)	52,005,195
Pakësime (K)	26,688,905
Gjendja debitorë në 31.12.2024	1,203,393,053

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Nga auditimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton se:

-Në fillim të vitit 2024 paraqitet në shumën 1,178,076,762 lekë, ndërsa në fund të vitit 2024 në shumën prej 1,203,393,053 lekë. Gjatë vitit 2024 shtesa prej 25,316,291 lekë vjen si rezultat i rritjes së debitorëve për taksa e tarifa vendore të Bashkisë Elbasan dhe njësive vartëse. Nga ana e drejtimit të Bashkisë Elbasan rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitorë dhe rritjen e performancës në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj.

Nga analiza e llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton se nuk janë përfshirë:

1- Gjendja e debitorëve nga gjobat e vendosura nga IMTV në vlerën 72,474,712 lekë nga të cilët; në zbatim të VKM nr.274, datë 09.05.2025“Për përcaktimin e procedurave dhe kriteret për shfuqizimin e masave administrative të papërfunduara”, bazuar në Ligjin nr. 127/2024, kanë përfituar 14 subjekte në vlerën 19,818,157 lekë. Mbeten debitorë të IMTV-së për tu pasqyruar në kontabilitet 21 subjekte në vlerën 52,656,555 lekë (72,474,712 lekë - 19.818.157 lekë)

2- Gjendja e debitorëve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë të konstatuar nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me program auditimi me nr.1093/1, datë 11.09.2024 në vlerën 17,221,950 lekë dhe shtesa e debitorëve për vitin 2024, për 12 persona në vlerën 492,486 lekë. Totali i debitorëve për tu kontabilizuar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë janë në vlerën 17,714,436 lekë (17,221,950 lekë + 492,486 lekë).

3- Gjendja e debitorëve nga kontratat e qirasë të fondit pyjor kullosorë në vlerën 12,368,615 lekë. Detyrimet për kontratat e qirasë të fondit pyjor kullosor sipas subjekteve paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela nr.8: Të dhëna për subjekte debitorë për fondin pyjor kullosorë.

Nr	Subjekti	Vlera/lekë
1	I. 2005 shpk 'Hec_Kamiçani'	499,615
2	“HSD E.” sh.p.k	3,861,000
3	A. S.	2,288,000
4	R. sh.p.k	5,720,000
Totali		12,368,615

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Liçensave dhe Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

Nga sa trajtuam më sipër rezulton se llogaria 468 (debitorë të ndryshëm) në fund të vitit 2024 nuk paraqet pamjen reale në raportimin financiar të Bashkisë Elbasan. Rezultojnë të ardhura të munguara si pasoje e mos kontabilizimit të debitorëve për vlerën 82,739,606 lekë.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22, me Ligjin Nr. 10 296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 dhe Ligjin nr. 14/2023 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 19 “Gjurma e auditimit”, neni 6 germa ç, neni 12 germa dh, neni 16 pika 2, dhe neni 22.

Në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39.

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :

Znj. A. M. /nëpunës zbatues Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” duhet të ketë në kundër parti të sajë llogarinë 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë” dhe llogarinë 4341 “Operacione me shtetin detyrime”.

Nga auditimi i pasqyrimit të llogarisë 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë” në pasqyrat e pozicionit financiar individuale dhe në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrës të konsoliduar u konstatua se kjo llogari është në vlerën zero lekë. Kjo llogari edhe në rakordimin e pozicionit financiar me thesarin sipas njësisve individuale është në vlerën zero lekë.

- **Llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta”** është një llogari që në pasqyrat financiare të njësisë

së qeverisjes së përgjithshme paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime/shërbime të kryera gjatë periudhës ushtrimore, të rimbursueshme nga shteti në bazë të kuadrit ligjor ose marrëveshjet e financimit për projekte të ndryshme. Për vitin 2024 sipas të dhënave të vena në dispozicion nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës kjo llogari në fillim të vitit ka qenë në vlerën 176,273,649 lekë është shtuar për vlerën 146,381,223 lekë dhe është pakësuar për vlerën 117,325,355 lekë. Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2024 është në vlerën 205,329,517 lekë. Bazuar në të dhënat e pasqyrës së pozicionit Financiar llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” në fund të vitit 2024 duhej të ketë në kundër parti llogaritë si më poshtë vijon:

Tabela nr.9: Llogaria kundër parti të llogarisë 4342-Operacione me shtetin të drejta.

Përshkrimi	Mbetja në fund të vitit 2024/lekë
Furnitorë dhe llogari te lidhura me to (401-408)	64,620,819
Detyrime ndaj personelit për pagat dhjetor (42)	91,547,388
Detyrime ndaj shteti për tatim page (431)	8,092,567
Detyrime ndaj sigurimeve shoqërore për dhjetor (435)	27,923,709
Detyrime për sigurime shëndetësore (436)	3,569,469
Kreditorë te ndryshëm (467)	1,235,956,242
Organizma te tjerë shtetërore (437,438)	145,200
Totali	1,431,855,394

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Për sa më sipër llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” duhet të ketë kundër parti llogaritë 401-408 “Furnitorë dhe llogari te lidhura me to”; llogaritë 42, 431, 435, 436, Detyrimet e pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale detyrime të Dhjetorit që paguhet në janar të vitit 2025; llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe llogaritë 437, 438 “Organizma te tjerë shtetërore”. Vlera totale e këtyre llogarive është 1,431,855,394 lekë e cila nuk përputhet me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin të drejta” e cila është në vlerën 205,329,517 lekë. Ndryshimi midis pasqyrimit të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin të drejta” me vlerën e sajë në fund të vitit 2024 sipas përllogaritjeve është për vlerën prej 1,226,525,877 lekë (1,431,855,394 lekë – 205,329,517 lekë).

Konkluzion: Llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” është pasqyruar në fund të vitit 2024 në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrës të konsoliduar në vlerën 205,329,517 lekë. Nga auditimi u konstatua që llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” nuk kuadron me shumën e llogarive (401-408, 42, 431, 435, 436, 437, 467, 437, 438); Llogaritë e detyrimeve të furnitorëve dhe llogarive të lidhura me to; Detyrimet e pagave dhe sigurimeve dhe tatimit mbi të ardhurat personale detyrime të Dhjetorit që paguhet në Janar të vitit 2025; Kreditorë të ndryshëm dhe Organizma të tjerë shtetërore; për vlerën totale prej 1,431,855,394 lekë. Llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” është nëvlerësuar për vlerën prej 1,226,525,877 lekë. Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 205,329,517 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar të konsoliduar dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 205,329,517 lekë.

- Konstatohet diferencë në raportim krahasuar me thesarin për llogarinë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, nga Agjencia e Kulturës dhe Turizmit për vlerën prej 3,620,796 lekë ku sipas pasqyrës së pozicionit financiar është 3,620,796 lekë ndërsa sipas thesarit zero lekë.

- Konstatohet diferencë në raportim krahasuar me thesarin për llogarinë 42 “Detyrime ndaj personelit”, nga Agjencia e Kulturës dhe Turizmit për vlerën prej 2,514,561 lekë ku sipas pasqyrës së pozicionit financiar është 2,514,561 lekë ndërsa sipas thesarit zero lekë.

- Konstatohet diferencë në raportim krahasuar me thesarin për llogarinë 43 “Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa”, nga Agjencia e Kulturës dhe Turizmit për vlerën prej 240,595 lekë ku sipas pasqyrës së pozicionit financiar është 240,595 lekë ndërsa sipas thesarit zero lekë.

- Konstatohet diferencë në raportim krahasuar me thesarin për llogarinë 435 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”, nga Agjencia e Kulturës dhe Turizmit për vlerën prej 760,150 lekë ku sipas pasqyrës së pozicionit financiar është 760,150 lekë ndërsa sipas thesarit zero lekë.

- Konstatohet diferencë në raportim krahasuar me thesarin për llogarinë 436 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shëndetësore”, nga Agjencia e Kulturës dhe Turizmit për vlerën prej 105,490 lekë ku sipas pasqyrës së pozicionit financiar është 105,490 lekë ndërsa sipas thesarit zero lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 32.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese kreu Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin. Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive kontabël të 4342 “Operacione me shtetin të drejta” germa b) “Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi: Debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”; Kreditohet llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :

Znj. A. M. /nëpunës zbatues Drejtorja e Buxhetit dhe Financës

Znj. B. L. /nëpunës zbatues Agjencia e Kulturës dhe Turizmit.

- **Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** në datë 31.12.2024, është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrës të konsoliduar në vlerën 18,480,336 lekë. Nga auditimi i të dhënave të pasqyrave financiare të pozicionit financiar të njësisve shpenzuese u konstatua që Agjencia e Shërbimeve Publike Elbasan gjendjen e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” sipas pasqyrës së pozicionit financiar e ka në vlerën prej 2,818,800 lekë ndërsa sipas të dhënave të thesarit për pozicionin financiar të llogarive është në vlerën 73,437,726 lekë ose është regjistruar në thesar më shumë për vlerën 70,618,926 lekë.

Nga kryqëzimi i të dhënave të pasqyrës së pozicionit financiar sipas pasqyrës me të dhënat e llogarive të pasqyrës sipas thesarit u konstatua që llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” sipas pasqyrave të pozicionit financiar individuale është në vlerën 18,480,336 lekë ndërsa sipas të dhënave të thesarit është në vlerën 89,099,262 lekë me një diferencë prej 70,618,926 lekë e regjistruar më shumë në thesar se në pasqyrat e pozicionit financiar.

Vlera prej 70,618,926 lekë e pasqyruar më shumë në thesar konstatohet në pasqyrën e pozicionit financiar të Njesisë Shpenzuese Agjencia e Shërbimeve Publike Elbasan.

Këto veprime janë në papajtueshmëri me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar ,neni 22, pika 3, germa “dh”.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar pika 15 Seksioni 3.1 “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Paragrafi 42 ndryshon si vijon:

“Degët e Thesarit regjistrojnë në SIFQ raportin/listën e faturave të siguruar sipas pikës 6 (b) të këtij udhëzimi lidhur me detyrimet e prapambetura të njësisve të qeverisjes së përgjithshme ndaj të tretëve

për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara për shkak të mungesës së fondeve publike. Për të evidentuar këto detyrime, degët e thesarit përdorin Llogarinë kontabël 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme", funksionimi i të cilit caktohet me udhëzim të veçantë dhe vetëm për qëllime monitorimi të performancës financiare të njësive të qeverisjes së përgjithshme. Regjistrimet e thesarit në Llogarinë 486 nuk janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar që prodhohet nga SIFQ në nivel njësie shpenzuese, ose njësie publike qendrore ose vendore për efekte rakordimi me këto të fundit.

Njësitet e qeverisjes së përgjithshme, përpara mbylljes së Llogarive vjetore 2021, kryejnë veprimin e mbylljes së Llogarisë 4864 "Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura" _në debi të Llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këto Llogari në datën 31 Dhjetor 2021.

Të gjitha detyrimet e prapambetura të regjistruara në Llogarinë 4864 deri në fund të periudhës ushtrimore 2021 konsiderohen detyrime të prapambetura të trashëguara nga vitet e kaluara."

Ne kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitet e qeverisjes së përgjithshme" pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39.

"Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitet e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 39 ndryshon përmbajtjen, si më poshtë: Këto pasqyra iu dërgohen njësive të qeverisjes së përgjithshme të Juridiksionit përkatës të degëve të thesarit për krahasimin e pasqyrës vërtetues me informacionin financiar të SIFQ, rakorduar gjatë vitit sipas paragrafit 37. Qëllimi kryesor është përgatitja e pasqyrave financiare Individuale për çdo njësi shpenzuese, përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar në nivel njësie publike qendrore ose vendore, së bashku me shënimet shpjeguese, ku analizohet diferenca midis vlerave kontabël të njësive dhe vlerave kontabël të SIFQ, veçanërisht diferenca midis zërave të Pasqyrës së Flukseve Monetare prodhuar nga SIFQ dhe zërat e Pasqyrës së Performancës Financiare prodhuar nga njësitet e qeverisjes së përgjithshme".

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi:

Znj. A. M./nëpunës zbatues Drejtoria e Buxhetit dhe Financës

Znj.B. D./nëpunës zbatues Agjencia e Shërbimeve Publike Elbasan.

II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e klasës 20 "Aktive afatgjata jo materiale", 21 "Aktive afatgjata materiale", 25-26 "Aktive afatgjata financiare" dhe 23 "Investime në proces" përbëhen nga:

- **Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"** në datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 110,081,149 lekë me kosto historike. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 16,949,347 lekë me kosto historike dhe amortizim të akumuluar në vlerën 45,098,167 lekë. Për vitin 2024 nuk ka pasur pakësim dhe në datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 127,030,496 lekë me kosto historike dhe me vlere neto të pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 45,098,167 lekë.

Nga krahasimi i të dhënave të pasqyrave të pozicionit financiar individuale me të dhënat e thesarit për llogarinë 202 "Studime dhe kërkime" nuk rezultuan diferenca.

Nga auditimi i llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" u konstatua se:

- Nga të dhënat analitike të llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" rezultojnë 14 studime dhe projekte të pasqyruara në vlerën e tyre historike 41,908,063 lekë të cilat janë të paanalizuara sipas investimeve që u përkasin. Këto projekte paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela nr.10: Të dhëna për llogarinë 202“Studime dhe kërkime”

Nr	Emërtimi	Vlera/lekë
1	Studime Urbanistike	1,450,000
2	verdhe te qytetit me sip.22Ha	388,800
3	Projekt nga FSHZH	515,131
4	Studime Projektme	8,308,800
5	Projekte	2,105,000
6	Administrata	7,681,080
7	Studime Kerkime	1,820,750
8	Studime Kerkime	1,747,766
9	Projekt	112,000
10	Projekt shkolle	72,000
11	Projekte	1,746,266
12	Administrata	1,945,500
13	Administrata	50,000
14	Hartim plan mbarështrimi	13,964,970
Totali		41,908,063

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

- Nga të dhënat në lidhje me objektet e përfunduara rezulton se nuk ka informacion në lidhje me përfundimin e objekteve që u përkasin 45 projektet në vlerën 127,030,496 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, klasa 2,pika 5 dhe pika 2.1 Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2. Njohja e AAGJ në pasqyrat financiare vjetore.

1. Aktivitet Afatgjatë Jo materiale.

Gjatë vitit 2024 janë transferuar aktive nga një njesi në tjetrën, brenda njërive, sipas shkresave nr.3070/1 datë 05.07.2024 me vendim nr 64., datë 03.07.2024 për Agjencinë e Kulturës me vlerë 29,250,367 lekë, me shkresën nr.785., datë 13.02.2025 me vlerë 158,493,187 lekë për ASHPU, me shkresën nr.786., datë 13.02.2025 në vlerën 13,868,864 lekë për Ish Klubin Shumësportesh, shkresa nr.787., datë 13.02.2025 në vlerën 268,440,615 lekë për Qendrën Ekonomike të Arsimit, shkresa 788 datë 13.02.2025 për ASHPR.

Shkresa 4375/1.prot., datë 03.10.2024 me vendimVKB nr 100., datë 03.10.2024 “Për miratimin e ndarjes së asetëve midis ASHPR dhe ASHPU”.

- **Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”** në datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 525,589,605 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 26,160,236 lekë dhe pakësim në vlerën 4,069,958 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 547,679,883 lekë.

E analizuar sipas objekteve gjendja e kësaj llogarie në 31.12.2024, paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela nr.11: Analiza për llogarinë 210 “Toka, troje, terrene”.

Emërtimi	Sip. m2	Vlera/lekë
Toka, troje,terrene	1	53,040,000
Toke varreza publike	6130	4,069,958
Shpron.zgjatim I Rr.L.Nosi, L.5 Maji seg.kryq. Rr.I.Dinci,bashkim unazen seg.B-C,hapja unaza veriore	1	6,969,657

Shpron.zgjatim I Rr.L.Nosi, L.5 Maji seg.kryq. Rr.I.Dinci,bashkim unazen seg.B-C,hapja unaza veriore	1	24,657,287
Shpron.seg. A-B L "11 Nentori",shpron.hapja unazes brndshme	1	38,651,414
Shpron.seg. Qe bashkon Rr.28 Nentori me Rr.rinia,hapja sist.Rr.11 Netori	1	13,058,975
Shpron.seg. Qe bashkon Rr.28 Nentori me Rr.rinia,hapja sist.Rr.11 Netori	1	2,192,250
Shpron.seg. Qe bashkon Rr.28 Nentori me Rr.rinia,hapja sist.Rr.11 Netori	1	802,978
- **Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”** në datën 31.12.2024, paraqitet në vlerën 342,749,869 lekë. Nga të dhënat shkresore (ekstraktet e QKB) të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në lidhje me kontabilizimin e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” u konstatua që:

- Bashkia Elbasan është aksionere në shoqërinë Akademia e Futbollit Elbasan me NIPT M13113202A me 30% të aksioneve të kësaj shoqërie. Sipas ekstraktit të QKB kjo shoqëri ka kapital në vlerën 3,592,895 lekë nga të cilat pjesa takuese e Bashkisë Elbasan është në vlerën 1,077,869 lekë($3,592,895 \cdot 30\%$).

- Bashkia Elbasan është aksionere në shoqërinë Eko-Elb me NIPT M13606204T me 52% të aksioneve të kësaj shoqërie. Sipas ekstraktit të QKB kjo shoqëri ka kapital në vlerën 3,500,000 lekë nga të cilat pjesa takuese e Bashkisë Elbasan është në vlerën 1,820,000 lekë($3,500,000 \cdot 52\%$).

- Bashkia Elbasan është aksionare në Sh. R. U. K. E. sha me NIPT M.....V me 28,52% të aksioneve të kësaj shoqërie. Sipas ekstraktit të QKB kjo shoqëri ka kapital në vlerën 10,000,000 lekë nga të cilat pjesa takuese e Bashkisë Elbasan është në vlerën 2,852,000 lekë($10,000,000 \cdot 28.52\%$).

- Bashkia Elbasan është aksionere në shoqërinë Trajtimi i Studentëve sha Elbasan me NIPT K53029201C me 100% të aksioneve të kësaj shoqërie. Sipas ekstraktit të QKB kjo shoqëri ka kapital në vlerën 337,000,000 lekë nga të cilat pjesa takuese e Bashkisë Elbasan është 337,000,000 lekë($337,000,000 \cdot 100\%$).

Nga auditimi i të dhënave të Llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” u konstatua që është paraqitur drejt kjo llogari në vlerën 342,749,869 lekë.

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e Klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Elbasan më datën 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit Dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.,.

- **Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** në datë 01.01.2024, është në vlerën 181,779,590 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 49,824,713 lekë dhe pakësim në vlerën 166,989,992 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 64,614,311 lekë. Grupit të auditimit nuk ju vunë në dispozicion të dhëna nga thesari për këtë llogari.

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” referuar pasqyrës së pozicionit financiare të pasqyrës të konsoliduar paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën 91,547,388 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2024 e cila mbetet për t’u paguar në muajin Janar të vitit pasardhës. Të dhënat e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit” sipas pasqyrave individuale të njëjësive shpenzuese dhe pasqyrës së konsoliduar të krahasuara me të dhënat e thesarit paraqitet si në tabelën në vijim:

Tabela nr. 23: Krahasimi me thesarin për llog. 42 “Detyrime ndaj personelit”/lekë.

Emërtimi I institucionit	Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"/pasqyra pozicionit financiar	Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"/ Thesari individuale	Diferenca
Bashkia Elbasan qendër	22,916,250	22,916,250	0
Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	11,041,041	11,041,041	0
Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	9,007,453	9,007,453	0
Agjencia e shërbimeve publike urbane	4,940,367	4,940,367	0
Klubi shume sportesh Elbasan	6,842,508	6,842,508	0
Qendra ekonomike arsimit	31,469,660	31,469,660	0
Qendra sociale balashe	2,815,548	2,815,548	0
Agjencia e kulturës dhe turizmit	2,514,561	0	2,514,561
Njësia administrimit banesave sociale			0
Qendra artit Elbasan			0
Bilanci i Konsoliduar	91,547,388	89,032,827	2,514,561

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Konstatohet diferencë në raportim krahasuar me thesarin për llogarinë 42 “Detyrime ndaj personelit”, nga Agjencia e Kulturës dhe Turizmit për vlerën prej 2,514,561 lekë ku sipas pasqyrës së pozicionit financiar është në vlerën 2,514,561 lekë ndërsa sipas thesarit zero lekë.

- **Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 8,092,567 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin Dhjetor. Të dhënat e llogarisë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” sipas pasqyrave individuale të njësive shpenzuese dhe pasqyrës së konsoliduar të krahasuara me të dhënat e thesarit paraqitet si në tabelën në vijim:

Tabela nr. 24: Krahasimi me thesarin për llog. 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”/lekë.

Nr.	Emërtimi I institucionit	Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" / pasqyra pozicionit financiar	Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" / Thesari individuale	Diferenca
1	Bashkia Elbasan qendër	2,632,282	2,632,282	0
2	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	1,162,705	1,162,705	0
3	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	465,680	465,680	0
4	Agjencia e shërbimeve publike urbane	320,305	320,305	0
5	Klubi shume sportesh Elbasan	551,174	551,174	0
6	Qendra ekonomike arsimit	2,498,098	2,498,098	0
7	Qendra sociale balashe	221,728	221,728	0
8	Agjencia e kulturës dhe turizmit	240,595	0	240,595
9	Njësia administrimit banesave sociale	0	0	0
10	Qendra artit Elbasan	0	0	0
11	Bilanci I Konsoliduar	8,092,567	7,851,972	240,595

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Konstatohet diferencë në raportim krahasuar me thesarin për llogarinë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, nga Agjencia e Kulturës dhe Turizmit për vlerën prej 240,595 lekë ku sipas pasqyrës së pozicionit financiar është në vlerën 240,595 lekë ndërsa sipas thesarit zero lekë.

- **Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore dhe për pagat e muajit Dhjetor të vitit 2024 që paguhen në muajin Janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerën 27,923,709 lekë. Të dhënat e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore” sipas pasqyrave individuale të

njësive shpenzuese dhe pasqyrës së konsoliduar të krahasuara me të dhënat e thesarit paraqitet si në tabelën në vijim:

Tabela nr. 25: Krahasimi me thesarin për llog. 435 “Sigurime shoqërore”/lekë.

Nr.	Emërtimi I institucionit	Llogaria 435 "Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore" / pasqyra pozicionit financiar	Llogaria 435 "Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore" / Thesari individuale	Diferenca
1	Bashkia Elbasan qendër	6,996,939	6,996,939	0
2	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	3,566,909	3,566,909	0
3	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	2,620,327	2,620,327	0
4	Agjencia e shërbimeve publike urbane	1,451,432	1,451,432	0
5	Klubi shume sportesh Elbasan	2,039,793	2,039,793	0
6	Qendra ekonomike arsimit	9,590,851	9,590,851	0
7	Qendra sociale balashe	897,308	897,308	0
8	Agjencia e kulturës dhe turizmit	760,150	0	760,150
9	Njësia administrimit banesave sociale	0	-	0
10	Qendra artit Elbasan	0	0	0
11	Bilanci I Konsoliduar	27,923,709	27,163,559	760,150

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Konstatohet diferencë në raportim krahasuar me thesarin për llogarinë 435 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”, nga Agjencia e Kulturës dhe Turizmit në vlerën 760150 lekë ku sipas pasqyrës se pozicionit financiar është 760,150 lekë ndërsa sipas thesarit zero lekë.

- **Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shëndetësore për pagat e muajit Dhjetor të vitit 2024 që paguhen në muajin Janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerën 3,546,469 lekë. Të dhënat e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore” sipas pasqyrave individuale të njësive shpenzuese dhe pasqyrës së konsoliduar të krahasuara me të dhënat e thesarit paraqitet si në tabelën në vijim:

Tabela nr. 26: Krahasimi me thesarin për llog. 436 “Sigurime shëndetësore” /lekë.

Nr.	Emërtimi I institucionit	Llogaria 436 "Detyrime ndaj shtetit për sigurime shëndetësore" / pasqyra pozicionit financiar	Llogaria 436 "Detyrime ndaj shtetit për sigurime shëndetësore" / Thesari individuale	Diferenca
1	Bashkia Elbasan qendër	978,355	978,355	0
2	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	473,907	473,907	0
3	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	381,956	381,956	0
4	Agjencia e shërbimeve publike urbane	201,427	201,427	0
5	Klubi shume sportesh Elbasan	283,149	283,149	0
6	Qendra ekonomike arsimit	1,086,964	1,086,964	0
7	Qendra sociale balashe	58,221	58,221	0
8	Agjencia e kulturës dhe turizmit	105,490	0	105,490
9	Njësia administrimit banesave sociale	0	0	0
10	Qendra artit Elbasan	0	0	0
11	Bilanci I Konsoliduar	3,569,469	3,463,979	105,490

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Konstatohet diferencë në raportim krahasuar me thesarin për llogarinë 436 “Detyrime ndaj shtetit për

sigurime shëndetësore”, nga Agjencia e Kulturës dhe Turizmit në vlerën 105,490 lekë ku sipas pasqyrës së pozicionit financiar është 105,490 lekë ndërsa sipas thesarit zero lekë

- **Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Elbasan në fillim të vitit 2024 ka qënë në vlerën 33,729,556 lekë. Gjatë vitit ka pasur shtesa në vlerën 27,590,528 lekë dhe paksim në vlerën 7,471,118 lekë. Gjendja në fund të vitit 2024 është në vlerën 53,848,966 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrave individuale të njësive të varësisë e krahasuar me të dhënat e thesarit paraqitet e njëjtë.

Nga auditimi i të dhënave të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” u konstatua se:

- Fonde që u përkasin objekteve të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Elbasan për të cilat ka informacion të detajuar janë për 45 objekte në vlerën 30,686,810 lekë.

- Për 38 objekte në vlerën 18,991,857 lekë nuk ka informacion të detajuar për këto objekte. Këto i përkasin; Qendrës Ekonomike të Arsimit 10 objekte në vlerën 13,225,944 lekë; Agjencisë së Pyjeve, Bujqësisë dhe Mjedisit një objekt në vlerën 145,275 lekë dhe Agjencia e Shërbimeve Publike 27 objekte në vlerën 5,620,638 lekë.

Njësitë shpenzuese kanë rakordimet përkatëse me degën e thesarit. Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masa për zhblokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës për 83 objekte në vlerën 49,678,667 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Kjo ka ndodhur pasi nuk ka patur bashkëpunim midis Drejtorisë së Planifikimit-Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës në lidhje me njoftimin e subjekteve sipas kontratave të përfunduara. Veprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10, ku përcaktohet që: *Pika 29. Më pas, bëhen rakordimet përkatëse të aktiveve dhe të detyrimeve në të dhënat e sistemit të thesarit, duke u mbështetur në dokumentacionin kontabël të prodhuar dhe evidentuar çdo transaksion financiar apo ngjarje të ndodhur për periudhën raportuese.*

Pika 30. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabile për llogari të vitit kontabël që mbyllet.

Pika 39. Këto pasqyra i’u dërgohen njësive të qeverisjes së përgjithshme të juridiksionit përkatës të degëve të thesarit, me qëllim përgatitjen dhe rakordimin e pasqyrave financiare të 10 njësisë me informacionin që gjendet në SIFQ. Në këtë mënyrë, njësitë e qeverisjes së përgjithshme, rakordojnë të dhënat e tyre në kontabilitet dhe pasqyrat financiare të vitit ushtrimor që kanë përgatitur me pasqyrat e mësipërme të gjeneruara nga SIFQ-i.

Pika 50. Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkangjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).

Pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i

punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.

- **Llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime”** paraqet detyrimet e prapambetura të cilat më datë 01.01.2024, janë në vlerën 3,804,000 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 3,488,500 lekë.

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të pasqyrës të konsoliduar konstatohet se, në pasiv të pasqyrës pasqyrohet llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime” që është në vlerën prej 3,488,500 lekë. E detajuar llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime” sipas pasqyrave të pozicionit financiar individuale paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr.27: Të dhëna për llog. 4341 “Operacione me shtetin detyrime”

Nr.	Emërtimi I institucionit	Llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime”/ pasqyra pozicionit financiar	Llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime”/ Thesari individuale
1	Bashkia Elbasan qendër	2,547,100	2,547,100
2	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	0	0
3	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	0	0
4	Agjencia e shërbimeve publike urbane	0	0
5	Klubi shume sportesh Elbasan	0	0
6	Qendra ekonomike arsimit	0	0
7	Qendra sociale balashe	0	0
8	Agjencia e kulturës dhe turizmit	0	0
9	Njësia administrimit banesave sociale	941,400	941,400
10	Qendra artit Elbasan	0	0
11	Bilanci I Konsoliduar	3,488,500	3,488,500

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Totali i llogarive 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë” + 4341 “Operacione me shtetin detyrime” sipas pasqyrës së pozicionit financiar të pasqyrës të konsoliduar është në vlerën 3,488,500 lekë.

Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës së pozicionit financiar sipas pasqyrës të konsoliduar me të dhënat e llogarive sipas njësive individuale u konstatua që llogaria 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë” + 4341 “Operacione me shtetin detyrime” është në vlerën 3,488,500 lekë. Llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” është në vlerën 1,203,393,053 lekë. Llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime” nuk kuadron me kundër partinë e saj llogarinë 468 për vlerën 1,199,904,553 lekë (1,203,393,053 lekë - 3,488,500 lekë). Llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime” është nënvlerësuar në paraqitjen e saj në pozicionin financiar të pasqyrës të konsoliduar për vlerën 1,199,904,553 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar ,neni 22, pika 3, germa “dh”. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese i ndryshuar pika 7 germa c “Për konstatimin paraprak të te drejtave për tu arkëtuar debitohe llogaritë e klasës e klasës 4 (411-468) “Debitorë të ndryshëm” dhe kreditohet llogaria 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë”. Në fund të vitit për debitorët e paarkëtuar, pjesa e buxhetit bëhet veprimi:

- Debitorohet llogaria 8424, “Transferim për debitorë të konstatuar”;

- *Kreditohet llogaria 4341, "Operacione me shtetin (detyrime)".*

Në kundërshtim me *Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme* i ndryshuar pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39.

"Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 39 ndryshon përmbajtjen, si më poshtë: Këto pasqyra iu dërgohen njësisive të qeverisjes së përgjithshme të Juridiksionit përkatës të degëve të thesarit për krahasimin e pasqyrës vërtetues me informacionin financiar të SIFQ, rakorduar gjatë vitit sipas paragrafit 37. Qëllimi kryesor është përgatitja e pasqyrave financiare Individuale për çdo njësi shpenzuese, përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar në nivel njësie publike qendrore ose vendore, së bashku me shënimet shpjeguese, ku analizohet diferenca midis vlerave kontabël të njësisive dhe vlerave kontabël të SIFQ, veçanërisht diferenca midis zërave të Pasqyrës së Flukseve Monetare prodhuar nga SIFQ dhe zërat e Pasqyrës së Performancës Financiare prodhuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :

Znj. A. M. nëpunës zbatues.

Znj. S. C. nëpunës zbatues njësia administrimit banesave sociale.

- **Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm"** paraqitet në datë 31.12.2024, janë në vlerën 1,235,956,242 lekë. E analizuar llogaria paraqitet si në tabelën në vijim;

Tabela nr. 28: Analiza për llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm"/lekë.

Emërtimi	Vlera/lekë
Shërbim kamera	3,578,400
Shërbim roje	17,179,098
Energji elektrike dhjetor 2024	6,241,200
UKE dhjetor 2024	502,656
Energji Elektrike	193,794
Uji	11,712
Shërbim telefoni	1,300
Bileta muzeu etnografik	3,600
Vërtetime sipas tabelës	20,000
Pulla park. Klevis Tabaku detyrim.2011	15,000
Pulla parkimi 2017	3,570,000
Tarife veterinare ngarkuar personat sipas tabelës	3,516,600
Qira objekti sipas tabelës	1,111,455
Gjopa policia bashkiake të trashëguara nga viti 2011	133,700
Aktkontrollet e .K.LSH ne vite Bashkia	28,464,025
Subjektet debitorë deri 31.12.2024 Bashkia	787,799,706
Debitorët familjare deri 31.12.2024	343,496,699
Aktkontrollet e K.LSH ne vite ish komuna Bradashesh	33,221,433
Debitorët e SHMZSH	1,151,750
FSHU	182,745
Shoqëria Rajonale e UKE	26,304
Totali më lart	1,230,421,177
QEA(Qendra Ekonomike e Arsimit)	5,535,065
Totali i përgjithshëm	1,235,956,242

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Nga verifikimi i llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" të pasqyrës së pozicionit financiar të

konsoliduar konstatohet se, në këtë llogari është pasqyruar vlera prej 1,235,956,242 lekë. Me shkresën e dërguar në M.F me nr.1033.prot., datë 25.02.2025 Bashkia Elbasan ka raportuar detyrime të prapambetura në vlerën 16,014,475 lekë nga të cilat vendime gjyqësore në vlerën 1,766,578 lekë, shërbime në vlerën 8,750,326 lekë, investime 1,891,810 lekë, mallra 3,605,761 lekë. Kjo llogari është pasqyruar në mënyrë të pasaktë pasi nuk pasqyron detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve por është paraqitur si kundër parti e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” për vlerën 1,200,952,433 lekë e detajuar si në tabelën në vijim:

Tabela nr. 29: Të dhëna për debitorët e paraqitur në llogarinë 467“*Kreditorë të ndryshëm*”.

Emërtimi	Vlera/lekë
Bileta muzeu etnografik	3,600
Vertetime sipas tabelës	20,000
Pulla park.Klevis Tabaku det.2011	15,000
Qera objekti sipas tabelës	1,111,455.02
Gjopa policia bashkiake trashëguar nga viti 2011	133,700
Aktkontrolltet e .K.LSH ne vite Bashkia	28,464,025
Subjektet debitore deri 31.12.2024 Bashkia	787,799,706.24
Debitorët familjare deri 31.12.2024	343,496,699
Aktkontrolltet e .K.LSH ne vite ish komuna Bradashesh	33,221,433
Debitorët e SHMZSH	1,151,750
QEA	5,535,065
Shuma	1,200,952,433

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Nga auditimi u konstatua se:

- Llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” ka mospërputhje dhe mbivlerësim të saj në raportim për vlerën 1,219,941,767 lekë (1,235,956,242 lekë - 16,014,475 lekë), krahasuar me raportimin e dërguar në MF.

- Llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” është paraqitur si kundër parti e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” për debitorët në vlerën 1,200,952,433 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, ku përcaktohet se llogaria 468 “*Debitor të ndryshëm*” duhet të ketë në kundër parti të sajë llogarinë 470 “*Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë*” dhe llogarinë 4341 “*Operacione me shtetin detyrime*”.

Këto janë veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022, Pika 15 Seksioni 3.1 “*Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, me të cilin Paragrafi 42 ndryshon si vijon:

Degët e Thesarit regjistrojnë në SIFQ raportin/listën e faturave të siguruar sipas pikës 6 (b) të këtij udhëzimi lidhur me detyrimet e prapambetura të njërive të qeverisjes së përgjithshme ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara për shkak të mungesës së fondeve publike. Për të evidentuar këto detyrime, degët e thesarit përdorin Llogarinë kontabël 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, funksionimi i të cilit caktohet me udhëzim të veçantë dhe vetëm për qëllime monitorimi të performancës financiare të njërive të qeverisjes së përgjithshme. Regjistrimet e thesarit në Llogarinë 486 nuk janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar që prodhohet nga SIFQ në nivel njësie shpenzuese, ose njësie publike qendrore ose vendore për efekte rakordimi me këto të fundit. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, përpara mbylljes së Llogarive vjetore 2021, kryejnë veprimin

e mbylljes së Llogarisë 4864 "Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura" në debi të Llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në këto Llogari në datën 31 Dhjetor 2021.

Të gjitha detyrimet e prapambetura të regjistruara në Llogarinë 4864 deri në fund të periudhës ushtrimore 2021 konsiderohen detyrime të prapambetura të trashëguara nga vitet e kaluara.

2. Të tjera pasive afatshkurtra të cilat përbëhet nga:

-Llogaria 419 "Kreditorë parapagime" në datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 881,020 lekë. Kjo llogari vjen e mbartur nga vitet e mëparshme ushtrimore.

II. Pasivet afatgjata.

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të pasqyrave financiare të konsoliduar konstatohet se në pasiv të pasqyrës financiare të konsoliduar pasqyrohet llogaria 16,17,18 "Huata Afat Gjata" në vlerën prej 15,439,499 lekë.

- **Llogaria 16,17,18 "Huata afat gjata"** në datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 15,439,499 lekë. Sipas pasqyrave individuale të pozicionit financiar paraqitet në vlerën 15,439,499 lekë vlerë e cila paraqitet edhe në pasqyrën e konsoliduar. E krahasuar me të dhënat e thesarit paraqitet në vijim:

Tabela nr. 30: Krahasimi me thesarin për llog. 16,17,18 "Huata afat gjata"/lekë.

Nr.	Emërtimi I institucionit	Huata Afat gjata/llogaria 16,17,18 pasqyra pozicionit financiar	Huata Afat gjata/llogaria 16,17,18 Thesari individuale	Ndryshimi
1	Bashkia Elbasan qendër	15,439,499	15,439,499	0
2	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	0		0
3	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	0		0
4	Agjencia e shërbimeve publike urbane	0		0
5	Klubi shume sportesh Elbasan	0		0
6	Qendra ekonomike arsimit	0		0
7	Qendra sociale balashe	0		0
8	Agjencia e kulturës dhe turizmit	0		0
9	Njësia administrimit banesave sociale	0	-126,056,789	-126,056,789
10	Qendra artit Elbasan	0		0
11	Bilanci I Konsoliduar	15,439,499	-126,056,789	

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Nga auditimi i pasqyrave individuale sipas pozicionit financiar të thesarit u konstatua që Njësia Administrimit Banesave Sociale ka të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar sipas thesarit vlerën prej minus 126,056,789 lekë ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrës individual kjo vlerë është zero lekë ose e regjistruar në thesar më pak për vlerën 126,056,789 lekë.

Në tërësi nga të dhënat e pasqyrave individuale të pozicionit financiar krahasuar me të dhënat e llogarive të pozicionit financiar sipas thesarit rezultojnë të regjistruara më pak në thesar llogaria 16,17,18 "Huata afat gjata".

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar pika 3.3. Trajtimi kontabël dhe funksionimi i Llogarive të klasës 5 "Llogaritë financiare".

"Funksionimi kontabël i Llogarisë 565 "Mjete monetare në organizma financiarë krediti"

Llogaria 565 "Mjete monetare në organizma financiarë krediti" është karakteristikë vetëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Kjo Llogari përfaqëson huatë e nënshkruara e të dhëna nga organizmi i kreditit. Fillimisht, këto akordime kalojnë në këtë llogari dhe përdoren sipas kritereve që ka vendosur kontrata

e lidhur midis organizmit lokal dhe organizmit të kreditit.

Debiti i Llogarisë 565 korrespondon me kreditin e Llogarisë 16 apo 17 "Hua afatshkurtër e afatgjatë nga organizma të ndryshëm krediti", për huatë e nënshkruara.

Llogaria 565 kreditohet për tërheqjet periodike të shumave në debi të Llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar", ose debitohet Llogaria 512 "Mjete monetare në bankë".

Shlyerje për pagesa të detyrimeve afatshkurtra e afatgjata dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me likuidimet. Në debi ka Llogarinë e klasës 4 për detyrimet ose dhe në debi të Llogarive 16 e 17 "Huatë afatshkurtra dhe afatgjata"

Per sa me siper mban pergjegjesi

Znj. A M. nepunes zbatues Bashkia Elbasan.

Znj. S. C. nepunes zbatues Njësia Administrata Banesave Sociale Elbasan.

Nga auditimi paraqitjes së pozicionit financiar të pasqyrës individual të Bashkisë Elbasan u konstatua që në fillim të vitit 2024 gjendja e llogarisë 16,17,18 "Huat afat gjata" është në vlerën 66,011,524 lekë dhe në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 15,439,499 lekë. Likuidimet e huasë për vitin 2024 janë në vlerën 50,572,025 lekë që pasqyrohet edhe në akt rakordimin me thesarin të Bashkisë Elbasan njësia qendër që për vitin 2024 llogaria 166 "Huamarrje principali" është në vlerën 50,572,025 lekë e cila është pasqaruar edhe në pasqyrën e flukseve monetare Cash Flow.

Nga auditimi i paraqitjes së pozicionit financiar të pasqyrës individual të Njesisë së Administrimit të Banesave Sociale u konstatua që në fillim të vitit 2024 gjendja e llogaria 16,17,18 "Huate afat gjata" është vlerën zero lekë dhe në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën zero lekë. Likuidimet e huas për vitin 2024 janë në vlerën 11,340,389 lekë që pasqyrohet edhe në akt rakordimin me thesarin të Njesisë së Administrimit të Banesave Sociale e cila për vitin 2024 llogaria 166 "Huamarrje principali" është në vlerën 11,340,389 lekë e pasqaruar edhe në pasqyrën e flukseve monetare Cash Flow.

Nga auditimi i pasqyrës së performancës së pasqyrave të konsoliduar të Bashkisë Elbasan u konstatua që në llogarinë 650 "Interesa për bono thesarit dhe kredi direkte" janë pasqyruar pagesa e principalit të kredisë për njësinë shpenzuese Bashkia Elbasan për vlerën 50,572,025 lekë që nuk duheshin pasqyruar si shpenzime pasi pagesa e principalit të kredisë nuk regjistrohet si shpenzim në pasqyrën e performancës financiare. Pasqyrimi në shpenzime i vlerës 50,572,025 lekë ka pakësuar llogarinë 85 "Rezultatin i veprimtarisë ushtrimore" për vitin 2024 në vlerën 50,572,025 lekë.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar aneksi1 pika 1.1.6 Grupi i Llogarive 16 "Bono thesari dhe huamarrje e brendshme" dhe grupi 17 "Huamarrje e huaj".

"Në përputhje me hapësirat ligjore në vazhdim, veçanërisht për organet e vetëqeverisjes vendore mund të krijohen premisa për huamarrjen e huadhënien direkte, pa ndërmjetësinë e qeverisë shqiptare, pra direkte me sistemin bankar,

Grupi i Llogarive 16 e 17, nga pikëpamja kontabël funksionon si më poshtë:

a) *Për nënshkrimin dhe marrjen e huasë, veprimet:*

Kreditohen Llogarite 16 dhe 17 (Për nënshkrimin dhe marrjen e huasë);

● *Debitohen Llogarite e klasës 4 (Për konstatimin e huasë); dhe*

● *Debitohen Llogarite e klasës 5 (Për marrjen efektive të huasë).*

b) *Për shlyerjen ose pagimin e principalit, veprimet:*

Debitohen Llogarite 16 dhe 17; dhe

● *Kreditohen Llogarite e klasës 4 ose klasës 5,*

c) *Për konstatimin ose pagimin e interesave, veprimet:*

Debitohet klasa 6 (Për shpenzimet financiare);
Kreditoheh Llogarite e klasës 4 (Për konstatimin e interesave); dhe
Kreditoheh Llogarite e klasës 5 (Për pagimin e interesave)".

Për sa më sipër mban përgjegjesi; Znj. A. M. nepunes zbatues Bashkia Elbasan dhe
Znj. S. C. nepunes zbatues Njësia Administrata Banesave Sociale Elbasan.

• **Paraqitja e Aktiveve neto dhe fondit të konsoliduar.**

Të dhënat për këto llogari në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 31: Fondi i konsoliduar.

Lekë

C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	9,278,879,551.41	9,023,380,694.52
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	9,278,879,551.41	9,023,380,694.52
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	8,397,619,546.52	8,096,202,981.94
12	Rezultatet e mbartura	53,208,484.00	12,599,737.84
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	388,392,855.89	376,404,078.74
115	Nga Fondet e veta te investimeve	81,621,626.00	64,317,230.00
116	Te ardhura te arkëtuar .nga shitja e tokës + ndërtesa		170,298.00
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme		
145	Grante brendshme. kapitale për pjesëmarrje. ne investim. ne te trete	358,037,039.00	473,686,368.00

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

-Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" në datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 8,397,619,546 lekë. E detajuar sipas njësive te varësisë është si më poshtë vijon:

Tabela nr. 32: Të dhëna për llog. 101 sipas njësive shpenzuese.

Lekë.

Nr.	Emërtimi I institucionit	Llogaria 101 "Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar"/ pasqyra pozicionit financiar 31.12.2024	Llogaria 101 "Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar"/llogaria 101 01.01.2024
1	Bashkia Elbasan qendër	3,210,147,860.52	3,273,298,454
2	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	53,257,762	11,949,224
3	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	1,681,703,244	3,167,745,812
4	Agjencia e shërbimeve publike urbane	1,541,700,134	
5	Klubi shume sportesh Elbasan	28,736,901	27,188,094
6	Qendra ekonomike arsimit	1,566,070,633	1,326,281,334
7	Qendra sociale balashe	9,134,388	9,156,952
8	Agjencia e kulturës dhe turizmit	57,193,503	22,081,532
9	Njësia administrimit banesave sociale	202,831,462.00	210,737,169
10	Qendra artit Elbasan	46,843,659	47,764,411
11	Bilanci i Konsoliduar duhej paraqitur	8,397,619,547	8,096,202,982

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës/përpunoi grupi i auditimit.

TË ARDHURAT

Nga auditimi i pasqyrës së performancës së pasqyrës të konsoliduar u konstatua që janë paraqitur të ardhura për vitin 2024 në vlerën 6,559,439,880 lekë, vlerë e cila përputhet me totalin e të ardhurave sipas pasqyrës së performancës financiare të Bashkisë qendër Elbasan dhe njësive shpenzuese. Paraqitja e të ardhurave sipas pasqyrës së performancës së pasqyrës të konsoliduar është si më poshtë vijon:

Tabela nr. 33: Të dhëna për të ardhurat.

Lekë.

Nr. Reshti	Nr. Llogarie	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	VITI USHTRIMOR 2024
a	b	c	l
1	A	TE ARDHURAT	6,559,439,880
2	70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	737,133,894
3	700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	1,481,475
4	7002	Tatim mbi Biznesin e vogël	1,481,475
5	702	2.Tatimi mbi Pasurinë	326,686,013
6	7020	Tatim mbi Pasurinë e paluajtshme	312,984,390
7	7029	Te tjera tatime mbi Pasurinë	13,701,623
8	703	3.Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	408,820,877
9	7033	Takse mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	86,415,261
10	7035	Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	322,405,616
11	704	4.Takse mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtarë	-
12	7040	Takse doganore per mallrat e importit	
13	705	5.Takse e rrugës	
14	708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombëtarë	145,529
15	709	7.Gjoha e Kamat vonesa	
16	75	II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE	-
17	750	NGA TE PUNESUARIT	
18	71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	327,138,496
19	710	1.Nga ndërmarrjet dhe pronësia	39,738,003
20	7101	Nga Ndërmarrjet publike financiare	
21	7109	Te tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	39,738,003
22	711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	282,764,973
23	7110	Tarifa administrative dhe rregullatorë	227,038,416
24	7111	Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	39,009,017
25	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	1,384,721
	7114	Te ardhura nga biletat	1,131,900
26	7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestri e zhdëmtime	14,200,919
27	719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore	4,635,520
28	76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE	-
29	760	Nga interesat e huadhënies se brendshme	
30	72	V.GRANTE KORENTE	5,247,626,864
31	720	1.Grant korrent i Brendshëm	5,247,626,864
32	7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	2,189,612,162
33	7201	Nga Buxheti për NJQP(Vendore)	2,646,860,224
34	7200	Grant nga nivele te tjera Qeverisje (K,Q)	112,220,692
35	7204	Pjesëmarrje e institucioneve ne tatime nacionale	63,979,270
36	7206	Financim I pritshëm nga buxheti	205,329,517
37	7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)	29,625,000
38	721	2.Grant korent I Huaj	-
39		Nga Qeveri te Huaja	
40		VI.TE ARDHURA TE TJERA	247,540,626
41	787	Tërheqje nga seksioni I investimeve	247,540,626
42	73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE	0

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Të detajuara të ardhurat sipas njësive shpenzuese paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela nr. 34: Të dhëna për të ardhurat sipas njësive të vartësisë.....

Lekë.

Nr.	Emërtimi I institucionit	Llogaria 7 "Te ardhurat"
1	Bashkia Elbasan qendër	5,160,516,808

2	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	112,547,537
3	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	194,001,995
4	Agjencia e shërbimeve publike urbane	244,889,088
5	Klubi shume sportesh Elbasan	77,132,669
6	Qendra ekonomike arsimit	592,592,653
7	Qendra sociale balashe	59,729,623
8	Agjencia e kulturës dhe turizmit	47,137,619
9	Njësia administrimit banesave sociale	11,662,639
10	Qendra artit Elbasan	59,229,249
11	Bilanci I Konsoliduar	6,559,439,880

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës së performancës financiare konstatohet që është paraqitur Llogaria 6040 (6040/1) “*Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë*” në pasqyrën e performancës së pasqyrës të konsoliduar në vlerën 1,544,776,902 lekë, vlerë e cila i përket pasqyrës së performancës së Bashkisë Qendër Elbasan. Nga auditimi i të dhënave të kësaj llogarie në pasqyrën e performancës së Bashkisë Qendër Elbasan u konstatua që në këtë llogari janë pasqyruar transferimet e fondeve për njësite e varësisë. Bashkia Qendër Elbasan ka paraqitur të ardhura 5,160,516,808 lekë nga të cilat ka transferuar 1,544,776,902 lekë te njësitë e varësisë. Nga auditimi i pasqyrave të performancës financiare individuale të njësisë së varësisë u konstatua që njësite e varësisë kanë raportuar të ardhura në vlerën 1,398,923,072 lekë, nga të cilat 87,501,115 lekë janë të ardhura të veta të krijuara nga njësitë e varësisë të paraqitura si më poshtë vijon:

Tabela nr. 35: Të dhëna për të ardhurat e njësite të varësisë sipas llojit.....

Lekë.

Nr.	Emërtimi i institucionit	Të ardhura sipas P.F	Të ardhura të veta
1	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	112,547,537	30,078,623
2	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	194,001,995	528,242
3	Agjencia e shërbimeve publike urbane	244,889,088	11,216,900
4	Klubi shume sportesh Elbasan	77,132,669	1,261,776
5	Qendra ekonomike arsimit	592,592,653	33,198,362
6	Qendra sociale balashe	59,729,623	1,446,442
7	Agjencia e kulturës dhe turizmit	47,137,619	276,400
8	Njësia administrimit banesave sociale	11,662,639	8,503,870
9	Qendra artit Elbasan	59,229,249	990,500
	Totali njësite e varësisë	1,398,923,072	87,501,115

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Nga analiza më sipër u konstatua që të ardhurat që duheshin raportuar në pasqyrën e performancës së pasqyrës së konsoliduar janë 5,160,516,808 lekë të Bashkisë Qendër të cilat janë pasqyruar në pasqyrën e performancës së pasqyrës të Bashkisë qendër si dhe të ardhurat e veta të njësite shpenzuese për shumën 87,501,115 lekë. Totali që duhej raportuar si e ardhur në pasqyrën e performancës së pasqyrës të konsoliduar është 5,248,017,923 lekë (5,160,516,808 lekë + 87,501,115 lekë)

Konkluzion: Të ardhura të paraqitura në pasqyrën e performancës së konsoliduar janë në vlerën 6,559,439,880 lekë ose janë pasqyruar më shumë për vlerën 1,311,421,957 lekë (6,559,439,880-5,248,017,923).

- Auditimi në lidhje me të ardhurat tatimore u fokusua në drejtim të rakordimit të të ardhurave sipas llojeve të tyre midis thesarit sektorit të taksave dhe tarifave vendore dhe Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. U kryen rakordimet e të ardhurave me thesarin sipas llojeve të tyre dhe

pasqyrimin e tyre në pasqyrën e performancës financiare të Bashkisë Elbasan dhe njësisive si dhe në pasqyrat financiare të konsoliduar. Nga auditimi i akt rakordimeve me thesarin për njësitë e varësisë nuk u konstatuan diferenca në pasqyrimin e tyre në pasqyrën e performancës financiare. Të dhënat në lidhje me të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore dhe jo tatimore sipas rakordimeve me thesarin janë si më poshtë vijon.

Tabela nr .36: Të dhëna për taksat e tarifatat vendore sipas njësisive shpenzuese..... **Lekë.**

Nr	Emertimi I institucionit	Llogaria 700 Te ardhura fitim kapitale	Llogaria 702/tatim mbi pasurine	Llogaria 703/Tatime mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit	Llogaria 708 te tjera tatime dhe taksa	Llogaria 710 nga ndermarrjet dhe pronesia	Llogaria 711 shërbime administrative te ardhura sekondare	Llogaria 720 Grand korent I brendshem dhe sponsorizime
1	Bashkia Elbasan qendër	1,481,475	326,686,013	398,666,153	145,529	1,271,949	244,040,275	117,708,576
2	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit			9,679,723		19,553,120	445,780	
3	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan			0		423,242	105,000	
4	Agjencia e shërbimeve publike urbane			475,000		0	10,741,900	
5	Klubi shume sportesh Elbasan			0		1,261,776		
6	Qendra ekonomike arsimit			0		8,189,045	24,958,675	
7	Qendra sociale balashe			0		0	1,446,442	
8	Agjencia e kulturës dhe turizmit			0		0	276,400	
9	Njësia administrimit banesave sociale			0		8,503,870		
10	Qendra artit Elbasan			0		135,000	855,500	
11	Bilanci I Konsoliduar	1,481,475	326,686,013	408,820,876	145,529	39,338,002	282,869,972	117,708,576

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Nga auditimi i ushtruar për të dhënat e të ardhurave sipas kodit të të ardhurave për taksat dhe tarifatat vendore dhe të ardhurave jo tatimore sipas thesarit me të ardhurat e raportuara në pasqyrën e performancës financiare të njësisive individuale u konstatua që ka diferenca në paraqitjen e të ardhurave në Bashkinë qendër Elbasan. Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Buxhetit dhe Financës nga ana e saj ka pasqyruar të dhënat në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore dhe të ardhurat jo tatimore sipas klasave të tyre që nuk përputhen me të dhënat e thesarit sipas kodeve përkatëse si më poshtë vijon:

Tabela nr .37: Krahasimi i të ardhurave nga taksat e tarifatat vend. me të dhënat e thesarit..... **Lekë.**

Llogaria	Emërtimi I te ardhurave	Vlera	Pasqyra e performancës financiare	Diferenca
1166100	Te ardhura nga shitja aksione futbollit	14,127,000	0	14,127,000
7002200	Tatim fitimi I thjeshtuar	1,481,475	1,481,475	-
7020100	Takse mbi token bujqësore	21,877,821		
7020200	Takse ndërtese	230,516,369		
7020600	Takse trualli	60,590,199		
720		312,984,389	312,984,389	-
7029200	Takse Kalim pronësie	13,701,622		
7029		13,701,622	13,701,622	-
7033016	Takse e mjeteve te përdorura	86,415,261		
7033		86,415,261	86,415,261	-
7035002	Zënie e hapësirave publike	29,698,398		
7035003	Ndërtime te reja	105,598,244		
7035005	Takse hoteli	8,219,790		
7035008	Takse reklame	4,272,175		
7035009	Takse tabelle	6,758,493		
7035013	Tarife gjelbërimi	41,898,629		
7035022	Tarife kantier ndërtimi	4,085,000		
7035023	Tarife ndriçimi	62,626,047		
7035029	Tarifa e urbanistikës	8,981,666		
7035031	Tarife fasade	1,150,274		
7035033	Tarife për vërtetime	1,426,323		
7035035	Tarife për ndotje mjedisi	25,371,559		
7035039	Tarife vendore për leje karburanti	7,000,000		
7035048	Tarife mirëmbajtje infrastrukture	5,164,292		
7035		312,250,890	312,250,890	-
7081006	Taksa e akteve te pulles	145,529	145,529	0

7109100	Qira toke bujqësore	513,709		
7109200	Qira trualli	112,126		
7109600	Qira objekti	646,114		
710		1,271,949	1,271,949	-
7110106	Leje certifikate transporti	2,026,342		
7110501	Tarife pastrimi	183,501,526		
7110510	Tarife për mirëmbajtje dhe kullim	7,865,118		
7110599	Taksa vendim këshilli(VKB)	22,672,728		
7110		216,065,714	216,065,714	-
7111007	Parkimi	12,567,900		
7111009	Karrotrec	33,000		
7111		12,600,900	12,600,900	-
7113009	Miratim projekti MNZ	660,000		
7113011	Shërbim MNZ	318,000		
7113099	Shitje shërbimi MNZ	194,736		
7113		1,172,736	1,172,736	-
7115409	Gjoha ndërtimi	2,200,000		
7115420	Gjoha te policisë bashkiake	844,650		
7115499	Gjoha biznesi	10,821,436		
7115600	Sekustrime dhe zhdëmtime	334,832		
		14,200,918	14,200,918	-
7190990	Te ardhura te tjera jo tatimore	4,479,878		
7204100	Taksa e rentës minerare	576,877		
7204102	Tatim mbi te ardhurat personale	63,402,393		
7204		63,979,270	63,979,270	-
7200102	Grant nga nivele te tjera te qeverisjes	24,104,306	24,104,306	-
7207010	Sponsorizime nga OJQ	29,625,000	29,625,000	-

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Konkluzion: Nga auditimi u konstatua që ka pasaktësi në paraqitjen e të ardhurave sipas llojit të tyre e cila vjen si pasojë e mos administrimit të saktë të llojeve të detyrimeve tatimore sipas llojit të tyre. Konstatohen pasaktësi në pasqyrimin e taksave dhe tarifave vendore nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës pasi ka paraqitur në pasqyrën e performancës financiare 14,127,000 lekë më pak të ardhura nga taksat dhe tarifave vendore dhe të ardhurat jo tatimore sipas klasave të tyre që nuk përputhen me të dhënat e thesarit sipas kodeve përkatëse të të ardhurave. Nuk është paraqitur si e ardhur “*Të ardhura nga shitja aksione futbollit*” në vlerën 14,127,000 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar neni 4 pika 7. “*Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar*”.

Në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 Të drejtat dhe përgjegjësitë e pika 1. “*Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi*”: Pika 1.3. “*Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve*”, sipas së cilës; germa ç).

Në kundërshtim me Udhëzim nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 pika 12 seksioni 3.1 “*Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshme paragrafi 37. Si dhe pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39.*

“*Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 39 ndryshon përmbajtjen, si më poshtë: Këto pasqyra iu dërgohen njësitëve të qeverisjes së përgjithshme të Juridiksionit përkatës të degëve të thesarit për krahasimin e pasqyrës*

vërtetues me informacionin financiar të SIFQ, rakorduar gjatë vitit sipas paragrafit 37. Qëllimi kryesor është përgatitja e pasqyrave financiare Individuale për çdo njësi shpenzuese, përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar në nivel njësie publike qendrore ose vendore, së bashku me shënimet shpjeguese, ku analizohet diferenca midis vlerave kontabël të njësive dhe vlerave kontabël të SIFQ, veçanërisht diferenca midis zërave të Pasqyrës së Flukseve Monetare prodhuar nga SIFQ dhe zërat e Pasqyrës së Performancës Financiare prodhuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi: A. M. /nëpunës zbatues Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

SHPENZIMET

Bashkia Elbasan në pasqyrën e konsoliduar ka paraqitur shpenzimet në klasat përkatëse si në tabelën në vijim:

Tabela nr .38: Të dhëna mbi shpenzimet në pasqyrën e konsoliduar.

Lekë.

B	SHPENZIMET	6,171,047,024.4
600	IPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	1,197,525,628.0
6001	Paga, personel I përhershëm	1,178,160,105.0
6002	Paga, personel I përkohshëm	19,365,523.0
6003	Shpërblime	
6009	Shpenzime te tjera për personelin	
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	199,671,849.3
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqërore	178,254,001.3
6011	Kontributi I Sigurimeve Shëndetësore	21,417,848.0
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	805,116,085.6
602	Mallra dhe shërbime te tjera	49,105,773.0
6020	Materiale zyre e te përgjithshme	8,801,302.0
6021	Materiale dhe shërbime speciale	71,894,997.0
6022	Shërbime nga te trete	508,173,049.6
6023	Shpenzime transporti	59,195,936.0
6024	Shpenzime udhëtimi	2,543,752.0
6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	29,895,443.0
6026	Shpenzime për qiramarrje	2,450,250.0
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	1,398,202.0
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen për hua	58,000.0
6029	Shpenzime te tjera operative	71,599,381.0
603	IV.SUBVECIONE	5,173,000.0
6030	Subvecione për difference çmimi	5,173,000.0
	V.TRANSFERIME KORENTE	3,746,760,546.9
604	1.Transferime korente te brendshme	1,603,269,391.9
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	1,544,776,901.9
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme	5,426,743.0
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	37,496,947.0
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse	15,568,800.0
605	2.Transferime korente me jashte	0.0
6051	Transferime Për Organizatat Ndërkombëtare	
606	3.Transferime për Buxhetet familjare e Individë	2,143,491,155.0
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	2,143,491,155.0
	VI.SHPENZIME FINANCIARE	53,647,600.9
65	1.Shpenzime Financiare te brendshme	53,647,600.9

650	Interesa për bono thesarit dhe kredi direkte	50,572,025.8
651	Interesa për huamarrje të t.j. Brendshme	3,075,575.1
66	2.Shpenzime Financiare të jashtme	0.0
660	Interesa për huamarrje nga Qeveritë Huaja	
	VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA	0.0
681	Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit	
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	-3,474,580.4
	IX.SHPENZIME TE TJERA	166,626,894.2
831	Caktime të ardhurash të funksionimit për investime	157,066,869.0
8420	Transferim I të ardhurave në buxhet	6,081,962.0
8421	Derdhje në buxhet të të ardhurave të papërdorura	3,482.8
8423	Transferim për efekt të ndryshimit të gjendjeve	3,474,580.4
85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES (Rezultati i Veprimtarisë së Vitit Ushtrimor)	388,392,855.9

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Nga auditimi i të dhënave të pasqyrave individuale të performancës financiare u konstatua që totali i shpenzimeve të paraqitura në pasqyrat e performancës financiare është 6,171,047,024 lekë, vlerë e cila e cila përputhet me të dhënat e pasqyrës së performancës së pasqyrës të konsoliduar të Bashkisë Elbasan.

Tabela nr .39: Të dhëna mbi shpenzimet sipas njësive shpenzuese.

Lekë.

Nr.	Emërtimi I institucionit	Llogaria 6 Shpenzimet ne total / sipas pasqyrës se performancës financiare	Llogaria 6 Shpenzimet ne total/ duhej paraqitur ne pasqyrën e performancës financiare	Diferenca
1	Bashkia Elbasan qendër	4,792,192,385	4,792,192,385	0
2	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	104,020,514	104,020,514	0
3	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	193,578,753	193,578,753	0
4	Agjencia e shërbimeve publike urbane	240,672,188	240,672,188	0
5	Klubi shume sportesh Elbasan	76,988,893	76,988,893	0
6	Qendra ekonomike arsimit	584,405,121	589,415,932	-5,010,811
7	Qendra sociale balashe	59,729,623	59,729,623	0
8	Agjencia e kulturës dhe turizmit	46,861,219	46,861,219	0
9	Njësia administrimit banesave sociale	8,358,768.62	8,358,768.62	0
10	Qendra artit Elbasan	59,228,749	59,228,749	0
11	Bilanci I Konsoliduar	6,171,047,024	6,171,047,024	0

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Sa shihet në pasqyrën më sipër ka diferenca në vlerën 5,010,811 lekë e cila do të trajtohet në më poshtë në analizën e llogarisë 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”.

- **Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”** për vitin 2024, paraqitet në vlerën 1,197,525,628 lekë. Nga auditimi i të dhënave të pasqyrave të performancës financiare individuale u konstatua që Qendra Ekonomike e Arsimit ka paraqitur shpenzime për paga në vlerën 413,916,447 lekë dhe nga mbledhja e nën llogarisë se sajë në pasqyrë rezultojnë në vlerën 418,927,258 lekë ose 5,010,811 lekë më shumë. Të detajuara të dhënat për pasqyrat e performancës financiare individuale paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela nr . 40: Të dhëna mbi llog.600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” sipas njësive shpenzuese/lekë.

Nr.	Emërtimi I institucionit	Llogaria 600 "Paga dhe përfitimet e punonjësve"/ sipas pasqyrës së performancës financiare	Llogaria 600 "Paga dhe përfitimet e punonjësve"/ duhej paraqitur në pasqyrën e performancës financiare	Diferenca
1	Bashkia Elbasan qendër	451,329,392	451,329,392	0
2	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	59,774,579	59,774,579	0
3	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	79,171,846	79,171,846	0
4	Agjencia e shërbimeve publike urbane	53,675,241	53,675,241	0
5	Klubi shume sportesh Elbasan	38,123,332	38,123,332	0
6	Qendra ekonomike arsimit	413,916,447	418,927,258	-5,010,811
7	Qendra sociale balashe	36,916,547	36,916,547	0
8	Agjencia e kulturës dhe turizmit	34,216,506	34,216,506	0
9	Njësia administrimit banesave sociale	2,643,195	2,643,195	0
10	Qendra artit Elbasan	22,747,732	22,747,732	0
11	Bilanci I Konsoliduar	1,192,514,817	1,197,525,628	0

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Konstatohet që paraqitja në pasqyrën e performancës financiare të pasqyrës të konsoliduar është në vlerën 1,197,525,628 lekë dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan ka korrigjuar gabimin e pasqyruar nga Qendra Ekonomike e Arsimit për vlerën 5,010,811 lekë.

- **Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”** për vitin 2024 paraqitet në pasqyrën e performancës së pasqyrës të konsoliduar në vlerën 199,671,849 lekë. Nga auditimi i të dhënave të pasqyrave të performancës financiare individuale të njësive shpenzuese u konstatua që të dhënat në bilancin e konsoliduar janë pasqyruar saktë në bazë të shumave të pasqyrave të performancës individuale. (Të detajuara të dhënat për njësitë individuale paraqiten në aneksin 1/45 bashkangjitur këtij raporti auditimi).

- **Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”** përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit. Për vitin 2024 paraqitet në pasqyrën e performancës së pasqyrës të konsoliduar në vlerën 805,116,086 lekë. Nga auditimi i të dhënave të pasqyrave të performancës financiare individuale të njësive shpenzuese u konstatua që të dhënat në bilancin e konsoliduar janë pasqyruar saktë në bazë të shumave të pasqyrave të performancës individuale. (Të detajuara të dhënat për njësitë individuale paraqiten në aneksin 1/46 bashkangjitur këtij raporti auditimi).

Llogaria sintetike 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, paraqitet në vlerën 805,116,086 lekë dhe përfaqëson vlerën e të gjitha shpenzimeve operative gjatë vitit 2024 përkatësisht si vijon:

- Gjendja e llogarisë analitike 6020 **“Materiale zyre e të përgjithshme”** në vlerën 8,801,302 lekë përfshin, blerje materiale kancelarie, blerje dokumentacioni, materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës, materiale për pastrim, dezinfektim, furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme.

- Gjendja e llogarisë analitike 6021 **“Materiale dhe shërbime speciale”** në vlerën 71,894,997 lekë përfshin pagesat e bursave për arsimin baze dhe të përgjithshëm, Blerje uniforma dhe rroba për policinë bashkiake dhe materiale të tjera speciale, etj.,.

- Gjendja e llogarisë analitike 6022 **“Shërbime nga të tretët”** në vlerën 508,173,049 lekë përfshin, pagesa për menaxhimin e mbetjeve, shërbimi i pastrimit të qytetit, shpenzime interneti, shërbim postar, elektriciteti, uji, etj.,.

- Gjendja e llogarisë analitike 6023 **“Shpenzime transporti”** në vlerën 59,195,936 lekë përfshin, shpenzime Karburant dhe vaj, pjesë këmbimi & goma, shpenzimet e siguracionit të mjeteve të transportit, shpenzime të tjera transporti.

- Gjendja e llogarisë analitike 6024 **“Shpenzime udhëtimi”** në vlerën 2,543,752 lekë përfshin, shpenzime udhëtim për brenda dhe jashtë vendit.

- Gjendja e llogarisë analitike 6025 “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” në vlerën 29,895,443 lekë përfshin, shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave, etj..
- Gjendja e llogarisë analitike 6026 “Shpenzime për qiramarrje” në vlerën 2,450,250 lekë përfshin, shpenzime për qiramarrje ambientesh.
- Gjendja e llogarisë analitike 6027 “Shpenzime për detyrime për kompensime legale” në vlerën 1,398,202 lekë përfshin, shpenzime për vendime gjyqësore.
- Gjendja e llogarisë analitike 6029 “Shpenzime të tjera operative” në vlerën 71,599,381 lekë përfshin, shpenzime për pagesa këshilltare dhe kryepleq shpenzime për pritje e përcjellje, shpenzime për aktivitete sociale.
- **Llogaria 603 “Subvencionet”**: në datë 31.12.2024, ka qenë në vlerën 5,173,000 lekë. Kjo llogari përfshin shpenzime për subvencionimin e transportit urban të autobusëve në vlerën 2,729,000 lekë. Nga auditimi i të dhënave të pasqyrave të performancës financiare individuale të njërive shpenzuese u konstatua që të dhënat në bilancin e konsoliduar janë pasqyruar saktë në bazë të shumave të pasqyrave të performancës individuale me përjashtim të Bashkisë Elbasan qendër. Konstatohet që Bashkia Elbasan qendër ka pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare llogarinë 603 “Subvencionet” në vlerën 5,173,000 lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 2,729,000 lekë. Kjo llogari përfshin shpenzime për subvencionimin e transportit urban të autobusëve në vlerën 2,729,000 lekë e cila është pasqyruar në vlerën 2,729,000 lekë edhe në ditarin e shpenzimeve buxhetore dhe në rakordimin me thesarin. Të detajuara të dhënat për pasqyrat e performancës financiare individuale paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela nr. 41: Të dhëna mbi llog. 603 “Subvencionet” sipas njërive shpenzuese/lekë

Nr.	Emërtimi I institucionit	Llogaria 603 "Subvencione"/sipas pasqyrës seperformancës financiare	Llogaria 603 "Subvencione"/duhej paraqitur ne pasqyrën eperformancës financiare	Diferenca
1	Bashkia Elbasan qendër	5,173,000	2,729,000	2,444,000
2	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	0	0	0
3	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	0	0	0
4	Agjencia e shërbimeve publike urbane	0	0	0
5	Klubi shume sportesh Elbasan	0	0	0
6	Qendra ekonomike arsimit	0	0	0
7	Qendra sociale balashe	0	0	0
8	Agjencia e kulturës dhe turizmit	0	0	0
9	Njësia administrimit banesave sociale	0	0	0
10	Qendra artit Elbasan	0	0	0
11	Bilanci I Konsoliduar	5,173,000	2,729,000	2,444,000

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Konkluzion: Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare të pasqyrës të konsoliduar u konstatua që llogaria 603 “Subvencionet” është paraqitur në vlerën 5,173,000 lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 2,729,000 lekë. Kjo llogari përfshin shpenzime për subvencionimin e transportit urban të autobusëve në vlerën 2,729,000 lekë e cila është pasqyruar në vlerën 2,729,000 lekë edhe në ditarin e shpenzimeve buxhetore dhe në rakordimin me thesarin. Konstatohet që janë pasqyruar më shume shpenzime në këtë llogari për vlerën 2,444,000 lekë duke ndikuar në llogarinë 85 “Rezultatin i veprimtarisë ushtrimore” dhe nënvlerësuar këtë llogari për vlerën 2,444,000 lekë.

Llogaria 604 “Transferime korente të brendshme” paraqitet në pasqyrën e performancës financiare të pasqyrës së konsoliduar për vitin 2024 në vlerën 1,603,269,392 lekë ku përfshihen llogarite si me poshtë vijon:

Tabela nr.42: Të dhëna për llog. 604 “Transferime korente të brendshme”/lekë.

604	1.Transferime korente te brendshme	1,603,269,392
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	1,544,776,902
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme	5,426,743
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	37,496,947
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurës	15,568,800

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Konstatohet që nën llogaritë nuk janë percaktuar saktë pasi janë dy nënlllogari 6040 “*Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë*”. Për arsye identifikimi grupi i auditimit llogaritë i përcaktoi 6040/1 dhe 6040/2.

Llogaria 6040 (6040/1) “*Transferime korente tek nivele tjera te Qeverisë*” në pasqyrën e performancës së pasqyrës të konsoliduar është paraqitur në vlerën 1,544,776,902 lekë vlerë e cila i përket pasqyrës së performancës të Bashkisë qendër Elbasan. Nga auditimi i të dhënave të kësaj llogarie në pasqyrën e performancës së Bashkisë qendër Elbasan u konstatua që në këtë llogari janë pasqyruar transferimet e fondeve për njësitë e varësisë.

Nga auditimi konstatohet që kjo llogari është mbivendosur si shpenzim në pasqyrën e performancës së pasqyrës të konsoliduar. Konstatohet që shpenzimet e transferuara në njësisë e varësisë nga Bashkia Elbasan qendër janë pasqyruar përkatësisht në shpenzimet e llogarive përkatëse të shpenzimeve buxhetore të kryera nga njësite e varësisë. Sipas shpenzimeve buxhetore në pasqyrat individuale të flukseve monetare Cash Flow të njësiteve shpenzuese janë kryer shpenzime për investime në vlerën 260,620,900 lekë dhe shpenzime korente në vlerën 1,357,462,047 lekë. Në total shpenzime sipas pasqyrave individuale të performancës Cash Flow të njësiteve shpenzuese janë në vlerën 1,618,082,947 lekë ose janë përdorur totali i transferimeve në vlerën 1,544,776,902 lekë dhe në vlerën 73,306,045 lekë nga të ardhura e veta të njësiteve. Të dhënat në lidhje me shpenzimet buxhetore të realizuara nga njësite e varësisë në vlerën prej 1,618,082,947 lekë të detajuara sipas llojit te tyre paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela nr. 43: Të dhëna për shpenzimet buxhetore të realizuara/lekë.

Emërtimi I institucionit	231 Pagesa për detyrime e investime nga vitet e kaluara /cash Flow	231 Për detyrime e Investime te viti ushtrimor/cash Flow	166 Pagesa për Huadhënie	Llogaria 600/paga te punonjësve	Llogaria 601/sigurime shoqërorë dhe shëndetësore	Llogaria 602/mallra dhe shërbime	Llogaria 604/ Transferime korrent te brendshme	Llogaria 606/Transferta për buxhet familjare dhe individë
Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit		37,490,807		49,264,582	8,227,971	17,785,615		120,000
Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	73,437,726	76,868,166		74,358,721	12,384,064	146,378,673		210,000
Agjencia e shërbimeve publike urbane		8,556,316		51,647,439	8,620,280	151,372,524		
Klubi shume sportesh Elbasan		1,937,736		32,212,784	5,376,571	32,493,761	1,500,000	80,000
Qendra ekonomike arsimit		54,485,473		412,776,683	68,920,137	96,657,519		2,204,900
Qendra sociale balashe		1,194,720		36,453,760	5,900,657	15,432,031		30,000
Agjencia e kulturës dhe turizmit		6,649,956		33,716,717	5,615,122	6,927,236		80,000
Njësia administrimit banesave sociale			11,340,389	2,887,396	478,851	37,503		40,000
Qendra artist Elbasan		0		24,759,300	4,316,377	36,854,484		
Totali i përdorimeve nga njësite	73,437,726	187,183,174	11,340,389	718,077,382	119,840,030	503,939,346	1,500,000	2,764,900

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Finances dhe Buxhetit / rakordimi i thesarit për shpenzimet.

Nga analizimi i të dhënave të paraqitura në pasqyrat individuale të performancës financiare të njësiteve të varësisë u konstatua që totali i shpenzimeve të njësiteve shpenzuese është në vlerën 1,373,843,929 lekë sipas të drejtave të konstatuara.

Tabela nr .44: Të dhëna për shpenzimet sipas njësisive shpenzuese/lekë.

Nr.	Emërtimi I institucionit	Llogaria 6 Shpenzimet ne total / sipas pasqyrës seperformancës financiare
1	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	104,020,514
2	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	193,578,753
3	Agjencia e shërbimeve publike urbane	240,672,188
4	Klubi shume sportesh Elbasan	76,988,893
5	Qendra ekonomike arsimit	584,405,121
6	Qendra sociale balashe	59,729,623
7	Agjencia e kulturës dhe turizmit	46,861,219
8	Njësia administrimit banesave sociale	8,358,768.62
9	Qendra artit Elbasan	59,228,749
	Totali njësite e varësisë	1,373,843,829

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Finances dhe Buxhetit.

Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës së performancës të pasqyrës së konsoliduar u konstatua që totali i shpenzimeve të vitit 2024 është në vlerën 6,171,047,024 lekë nga të cilat llogaria 604 “*Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise*” paraqitet në vlerën 1,544,776,902 lekë. Kjo vlerë i përket pasqyrës së performancës së Bashkisë Elbasan (qendër). Nga verifikimi i të dhënave të kësaj llogarie në pasqyrën e performancës së Bashkisë Elbasan (qendër) u konstatua që në këtë llogari janë pasqyruar transferimet e fondeve për njësite e varësisë. Nga analiza e të dhënave individuale të pasqyrës së performancës financiare të njësisive shpenzuese u konstatua që njësitë e varësisë kanë pasqyruar si shpenzim në pasqyrën e performancës të konsoliduar vlerën prej 1,373,843,829 lekë. Paraqitja e shpenzimeve në pasqyrën e performancës financiare të pasqyrës së konsoliduar është kryer në mënyrë të pasaktë për vlerën 1,373,843,829 lekë pasi ka sjellë dublimin e shpenzimeve të njësisive shpenzuese. Konstatohet që shpenzimet e vitit ushtrimor janë paraqitur në mënyrë të pasaktë për vlerën prej 1,373,843,829 lekë duke u mbi vlerësuar si shpenzime.

Konkluzion: Në pasqyrën e performancës financiare të konsoliduar nga ana e Bashkisë Elbasan janë paraqitur shpenzime në vlerën 6,171,047,024 lekë dhe duheshin paraqitur 4,797,203,195 lekë(6,171,047,024-1,373,843,829) duke u mbivlerësuar në shumën 1,373,843,829 lekë.

Nga të dhënat e mësipërme përforcohet fakti që transferimet që u janë dhënë njesive të varesisë nga Bashkia Elbasan (qendër) nëpërmjet llogarisë 604 “*Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise*” në vlerën 1,544,776,902 lekë janë paraqitur si shpenzime nga njësitë e varësisë sipas pasqyrave individuale të performancës financiare në vlerën 1,373,843,829 lekë kjo do të thotë që shumja prej 170,933,073 lekë janë shpenzime sipas të drejtave të konstatuara që nuk janë dubluar në pasqyrën e performancës financiare të pasqyrës të konsoliduar (1,544,776,902 lekë - 1,373,843,829 lekë).

Konkluzion: Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës së performancës së pasqyrës të konsoliduar u konstatua që llogaria 604 “*Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë*” paraqitet në vlerën 1,544,776,902 lekë. Kjo vlerë i përket pasqyrës së performancës së Bashkisë qendër Elbasan. Nga auditimi i të dhënave të kësaj llogarie në pasqyrën e performancës së Bashkisë qendër Elbasan u konstatua që në këtë llogari janë pasqyruar transferimet e fondeve për njësite e varësisë. Nga auditimi i të dhënave individuale të pasqyrës së performancës financiare të njësisive shpenzuese u konstatua që njësitë e varësisë kanë pasqyruar si shpenzim në pasqyrën e performancës të pasqyrës së konsoliduar vlerën prej 1,373,843,829 lekë. Paraqitja e shpenzimeve në pasqyrën e performancës financiare të pasqyrës së konsoliduar është kryer në mënyrë të pasaktë për vlerën 1,373,843,829 lekë, pasi ka sjellë dublimin e shpenzimeve të njësisive shpenzuese. Konstatohet që shpenzimet e vitit ushtrimor të vitit 2024

janë paraqitur në mënyre të pasaktë për vlerën prej 1,373,843,829 lekë duke u mbi vlerësuar si shpenzime dhe duke ndikuar në llogarinë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” dhe duke nënvlerësuar këtë llogari për vlerën 1,373,843,829 lekë.

- Nga auditimi i ditarit të shpenzimeve të Bashkisë Elbasan qendër u konstatua që llogaria 6041 “Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme” përfaqëson transferimin të graveve korente Këshillit të qarkut Elbasan për vlerën 5,426,743 lekë.

- Nga auditimi i ditarit të shpenzimeve të Bashkisë Elbasan qendër u konstatua që llogaria 6040(6040/2) “Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë” e paraqitur në vlerën 37,496,947 lekë përfaqëson pagesa për fatkeqësi natyrore dhe pagesa për investime. Në këtë nën llogari u konstatua se janë paraqitur shpenzime për investime në objekte në vlerën 19,089,830 lekë të cilat nuk duhej të paraqiteshin në këtë llogari pasi nuk janë shpenzime korente por shpenzime për investime kapitale.

Tabela nr .45: Të dhëna për llog. 6040 “Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë” /lekë.

U.P.	Data	Pershkrimi i veprimtimit	6040
910	15.10.2024	B. Perforcim themeli këmbës urës me hapësire drite 17m ne perroin Xibrakes	4,500,000
1272	"	F. Sh.p.k. Ndërtim muri mbrojtës nga përroi Gurra dhe ndërtim tombino tërthore, fshati Shushice Nj.A.Shushice	4,261,680
1273	"	F. Sh.p.k. Ndërtim i urës mbi përroin Gorrej,degezim i perroit Paper,fshati Paper-Sollak,Nj.A.Paper	3,694,780
1005	"	F. Sh.p.k. Ndert.ures mbi perroin Llinxhes ne fshatin Jagodine,Nj.Adm.Shushice e rikonstr.ures se perroit Balta e Gaxhjes ne rr.e lagj.Katund Vjeter,fshati Shushice,Nj.A.Shushice	1,993,176
1259	"	Xh. Sh.p.k. "Rikonstrukcioni i disa urave"	1,721,570
983	30.10.2024	Xh. Sh.p.k. "Ndert muri prites rr.Hysen Ali Kopili,1.5 Maj per mbrojtjen e 2 banesave nga rreshqitja"	1,352,784
907	11.10.2024	Xh. Sh.p.k. Riparim argjinaures mbrojtese te perroit Zaranikes	317,213
764	"	G&L C Sh.p.k. Mbikq."Ndert ures qe lidh rrugen Papri me rrugen Xhikzonjes ne perroin e Gostimes"	217,860
1258	"	Xh. Sh.p.k. "Ndert muri prites rr.Hysen Ali Kopili,1.5 Maj per mbrojtjen e 2 banesave nga rreshqitja"	200,680
981	"	M. C. Sh.p.k. Mbikqyrje objek"Riparim argjinaures mbrojtese perroit Zaranikes"	190,533
1282	"	M. C. Mbikqyrje"Ndertim muri mbrojtjes nga perroi Gurra dhe ndertim tombino terthore,fshati Shushice Nj.A.Shushice"	127,361
945	23.10.2024	B. N. Ndertim muri mbrojtjes rruges varrezave fshati Labinot Katund,Nj.A.L.M	124,414
1283	"	M. C. Mbikqyrje"Ndertim i ures mbi perroin Gorrej,degezim i perroit Paper,fshati Paper-Sollak,Nj.A.Paper"	97,950
976	"	B. T. S. Mbikqyrje objek"Perforcim themeli kembes ures me hapësire drite 17m perroin Xibrakes"	92,000
1277	"	N. S. Mbikqyrje "Rikonstrukcion i disa urave"	42,042
1278	"	Z & CO Sh.p.k. Mbikqyrje "Ndertim muri prites ne rr.H.Ali Kopili,1.5 Maj per mbrojtjen e 2 banesave ng arreshqitja"	38,161
980	"	H. XH. PF Kolaudim objek"Riparim argjinaures mbrojtese perroit Zaranikes"	31,200
956	28.10.2024	E. S. PF Kolaudim "Ndertim ures qe lidh rr.Papri me rr.Xhikzonjes ne perroin e Gostimes "	29,950
974	29.10.2024	M. C. Sh.p.k. Mbikqyrje objek"Ndertim muri mbrojtjes rr.varrezave fshati L.Katund,Nj.A.L.M"	17,062
979	"	E. S. PF Kolaudim objek"Perforcim themeli kembes ures me hapësire drite 17m perroin Xibrakes"	14,750
724	16.08.2024	F. Sh.p.k. Ndertim i ures qe lidh rrugen Papri me rrugen Xhikzonjes ne perroin e Gostimes	12,000
1279	"	E. S. PF Kolaudim "Rikonstrukcion i disa urave"	5,600
1280	"	E. S. PF Kolaudim "Ndertim muri prites ne rr.H.Ali Kopili,1.5 Maj per mbrojtjen e 2 banesave ng arreshqitja"	5,000
975	"	H. XH. PF Kolaudim objek"Ndertim muri mbrojtjes rr.varrezave fshati L.Katund,Nj.A.L.M"	2,064
TOTALI			19,089,830

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Konkluzion: Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare të pasqyrës të konsoliduar u konstatua që në llogarinë 6040(6040/2) “Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë” është paraqitur vlera 37,496,947 lekë që përfaqëson pagesa për fatkeqësi natyrore dhe pagesa për investime. Nga analiza e kësaj nën llogarie u konstatua se në këtë llogari janë paraqitur shpenzime për investime në objekte në vlerën 19,089,830 lekë të cilat nuk duhej të paraqiteshin në këtë llogari pasi nuk janë shpenzime korente por shpenzime për investime kapitale.

Konstatohet që janë pasqyruar më shumë shpenzime në këtë llogari për vlerën 19,089,830 lekë duke ndikuar në llogarinë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” dhe nënvlerësuar këtë llogari për vlerën 19,089,830 lekë.

- **Llogaria 65 “Shpenzime financiare”** paraqitet në pasqyra financiare për vitin 2024 në vlerën 53,647,600 lekë e përberë nga “Interesa për bono thesari dhe kredi direkte” në vlerën 50,572,025 lekë ku përfshihen pagesa për principalin e kredisë. Nga auditimi i shpenzimeve të pasqyruara në këtë llogari

u konstatua që në këtë llogari nuk duheshin të pasqyroheshin shpenzimet prej 50,572,025 lekë trajtuar në akt konstatim në analizën e llogarisë 16,17,18 “*Huat afat gjata*”

- **Llogaria 606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në pasqyra financiare për vitin 2024 në vlerën 2,143,270,273 lekë ku përfshihen pagesa për invalidë, pagesa paaftësie dhe pagesa të ndihmës financiare. Nga auditimi i shpenzimeve të pasqyruara në këtë llogari u konstatua që sipas akt rakordimit me thesarin të njërive individuale kjo llogari është në vlerën 2,143,270,273 lekë dhe përputhet me raportimin në pasqyrat e konsoliduar të performancës financiare. (Të detajuara të dhënat sipas njërive individuale paraqiten në aneksin 1/47 bashkangjitur këtij raporti auditimi).

- **Llogaria 63 “Ndryshimi i Gjendjes së Inventarit”** paraqitet në fund të vitit 2024 në pasqyrën e konsoliduar në vlerën - 3,474,580 lekë. Nga analizimi i rakordimeve të pasqyrave të performancës financiare individuale sipas njërive me thesarin u konstatua që vlera e regjistruar në thesar për këtë llogari është 26,482,221 lekë. E detajuar sipas njërive të varësisë paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr. 46: Të dhëna për Llogarinë 63 “Ndryshimi i Gjendjes së Inventarit”/lekë.

Nr.	Emërtimi i institucionit	Llogaria 63 "Ndryshim gjendjes se inventarit" sipas thesarit	Llogaria 63 "Ndryshim gjendjes se inventarit" sipas pasqyrave performancës	Ndryshimi
1	Bashkia Elbasan qendër	(2,340,436)	-2,340,436	(0)
2	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	-	-7,676,448	7,676,448
3	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	26,917,279	26,917,279	-
4	Agjencia e shërbimeve publike urbane	-	-22,280,354	22,280,354
5	Klubi shume sportesh Elbasan	(920,749)	-920,749	-
6	Qendra ekonomike arsimit	4,193,134	4,193,134	-
7	Qendra sociale balashe	82,437	82,437	-
8	Agjencia e kulturës dhe turizmit	(536,399)	-536,399	-
9	Njësia administrimit banesave sociale	-	0	-
10	Qendra artit Elbasan	(913,045)	-913,045	-
11	Bilanci I Konsoliduar	26,482,221	-3,474,580	29,956,801

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Nga auditimi u konstatua se Agjencia e Pyjeve, Bujqësisë dhe Mjedisit ka paraqitur në pasqyrën e performancës financiare individuale Llogarinë 63 “*Ndryshimi i gjendjes se inventarit*” vlerën minus - 7,676,448 lekë dhe nga të dhënat e thesarit kjo llogari është në vlerën zero lekë dhe nuk rakordon për vlerën 7,676,448 lekë.

Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane ka paraqitur në pasqyrën e performancës financiare individuale Llogarinë 63 “*Ndryshimi i gjendjes se inventarit*” vlerën 26,917,279 lekë dhe nga të dhënat e thesarit kjo llogari është në vlerën zero lekë dhe nuk rakordon për vlerën 22,280,354 lekë.

Nga auditimi i paraqitjes së Llogarisë 63 “*Ndryshimi i gjendjes se inventarit*” në pasqyrën e konsoliduar u konstatua që kjo llogari është paraqitur (- 3,474,580) lekë ndërsa sipas pasqyrave individuale të rakordura me thesarin kjo llogari paraqitet në vlerën 26,482,221 lekë ose nuk rakordon me thesarin për vlerën 29,956,801 lekë. Diferenca në rakordim paraqitet në njësinë e varësisë Agjencia e Pyjeve, Bujqësisë dhe Mjedisit për vlerën 7,676,448 lekë dhe nga Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane në vlerën 22,280,354 lekë.

Këto veprime në kundërshtim me *Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39.

“*Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 39 ndryshon përmbajtjen, si më poshtë: Këto pasqyra iu dërgohen njërive të qeverisjes së përgjithshme të Juridiksionit përkatës të degëve të thesarit për krahasimin e bilancit vërtetues me informacionin financiar të SIFQ, rakorduar gjatë vitit sipas paragrafit 37. Qëllimi kryesor*

është përgatitja e pasqyrave financiare Individuale për çdo njësi shpenzuese, përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar në nivel njësie publike qendrore ose vendore, së bashku me shënimet shpjeguese, ku analizohet diferenca midis vlerave kontabël të njërive dhe vlerave kontabël të SIFQ, veçanërisht diferenca midis zërave të Pasqyrës së Flukseve Monetare prodhuar nga SIFQ dhe zërat e Pasqyrës së Performancës Financiare prodhuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi:

Z. E. D. Nepunes zbatues Agjencia e Pyjeve, Bujqësisë dhe Mjedisit.

Znj. L. T. Nepunes zbatues Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane.

Znj. A. M. Nepunes zbatues Bashkia Elbasan.

- Llogaria 85 “Rezultati i Veprimtarisë së Vitit Ushtrimor”. Në pasqyrën e performancës të pasqyrave të konsoliduar, të ardhurat e pasqyruara janë në vlerën 6,559,439,880 lekë dhe shpenzimet janë pasqyruar në vlerën 6,171,047,024 lekë. Rezultati i veprimtarisë ushtrimore është pasqyruar në vlerën 388,392,856 lekë (6,559,439,880 lekë - 6,171,047,024 lekë).

Nga analizat e kryera më sipër, në kapitujt përkatës, për llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve ka rezultuar se:

1- Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore/ Teprica e periudhës” është nënvlerësuar për vlerën 62,421,872 lekë. Të dhënat për përllogaritjet e kryera nga grupi i auditimit paraqiten në pasqyrën në vijim:

Tabela nr. 47: Të dhëna për përllogaritjet e kryera për të ardhurat dhe shpenzimet/lekë.

Nr.	Emërtimi	Vlera
1	Te ardhura paraqitur	6,559,439,880
2	Te ardhura duhet paraqitur	5,248,017,923
3=1-2	Diferenca	1,311,421,957
4	Shpenzime paraqitur	6,171,047,024
5	Shpenzime duhet paraqitur	4,797,203,195
6=4-5	Diferenca	1,373,843,829
7=2-5	Llogaria 85 duhet paraqitur	450,814,728
8	Llogaria 85 është paraqitur	388,392,856
9=7-8	Diferenca	62,421,872

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës./përpunoi grupi i auditimit.

2- Në llogarinë 65 “Shpenzime financiare” janë pasqyruar më shumë shpenzime në vlerën 50,572,025 lekë që kanë të bëjnë me pagesa për principalin e kredisë në vlerën 50,572,025 lekë.

3- Në llogarinë 6040(6040/2) “Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë” janë paraqitur në shpenzime ushtrimore më shumë në vlerën 19,089,830 lekë, që kanë të bëjnë me vlerën e investimeve në objekte.

4- Në llogarinë 603 “Subvencionet” janë pasqyruar më shumë shpenzime në këtë llogari për vlerën 2,444,000 lekë duke ndikuar në llogarinë 85 “Rezultatit i veprimtarisë ushtrimore” dhe duke e nënvlerësuar llogarinë 85 për vlerën 2,444,000 lekë.

Konkluzion: Nga auditimi i kryer u konstatua se llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore/ Teprica e periudhës” është nënvlerësuar për vlerën 134,527,727 lekë (62,421,872 lekë + 19,089,830 lekë + 50,572,025 lekë + 2,444,000 lekë). Kjo llogari në datën 31.12.2024 duhet të jetë në vlerën 522,920,583 lekë (388,392,856 lekë + 134,527,727 lekë).

- Auditim mbi pasqyrimin e pagesave në pasqyrën Cash'Flow.**

Grupi i auditimit kreu auditimin në lidhje me pasqyrimin e totalit të pagesave për detyrime të

shpenzimeve korente dhe kapitale si dhe shpezimet për huadheniet të pasqyruara në pasqyrat individuale të Flukseve monetare Cash Flow dhe prmbledhja e tyre në pasqyrën Cash Flow të pasqyrës të konsoliduar. Të dhënat për pagesat sipas njësive shpenzuese dhe llojit të detyrimeve paraqiten në pasqyrën në vijim:

Tabela nr. 48: Të dhëna për nga pasqyrat individuale të Flukseve monetare Cash Flow /lekë.

Nr.	Emërtimi i institucionit	Pagesa për detyrime e shpenzime korente/cash Flow	Pagesa për detyrime e investime nga vitet e kaluara /cash Flow	Për detyrime e Investime te viti ushtrimor/cash Flow	Pagesa për Huadhenie
1	Bashkia Elbasan qendër	-3,058,514,417	-39,437,359	-359,692,739	-50,572,026
2	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	-75,398,168		-37,490,807	
3	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	-235,065,090	-73,437,726	-76,868,166	
4	Agjencia e shërbimeve publike urbane	-211,750,243		-8,556,316	
5	Klubi shume sportesh Elbasan	-71,957,116		-1,937,736	
6	Qendra ekonomike arsimit	-583,168,943		-54,485,473	
7	Qendra sociale balashe	-57,816,448		-1,194,720	
8	Agjencia e kulturës dhe turizmit	-43,339,076		-6,649,956	
9	Njësia administrimit banesave sociale	-3,443,751			-11,340,389
10	Qendra artit Elbasan	-65,930,161		0	
11	Bilanci I Konsoliduar duhet paraqitur	(4,406,383,413)	-112,875,085	-546,875,913	-61,912,415
	Bilanci i Konsoliduar paraqitur	-4,409,383,413	-112,875,085	-546,875,913	-61,912,415
	Diferenca	(3,000,000)	-	-	-

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Nga prmbledhja e të dhënave të pasqyruara u konstatua që pagesa për shpenzime korente sipas Cash Flow sipas shumës së pasqyrave individuale është në vlerën 4,406,383,413 lekë dhe në pasqyrën e konsoliduar është paraqitur në vlerën 4,409,383,413 lekë ose 3,000,000 lekë me shumë.

Nga të dhënat në lidhje me shpenzimet buxhetore të realizuara rezultojnë shpenzime buxhetore të klases 6 në vlerën 4,389,472,859 lekë sipas të dhënave të detajuara si në tabelën në vijim:

Tabela nr. 49: Të dhëna për shpenzimet buxhetore sipas thesarit /lekë.

Nr.	Emërtimi i institucionit	Llogaria 600/paga te punonjësve	Llogaria 601/sigurime shoqërorë dhe shëndetësore	Llogaria 602/mallra dhe shërbime	Llogaria 603/ subvencione	Llogaria 65/shpenzime financiare	Llogaria 604/Transferime korrente te brendshme	Llogaria 606/Transferta për buxhet familjare dhe individë
1	Bashkia Elbasan qendër	457,833,288	76,233,386	311,423,647	2,729,000	3,075,575	51,550,932	2,140,505,373
2	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	49,264,582	8,227,971	17,785,615				120,000
3	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	74,358,721	12,384,064	146,378,673				210,000
4	Agjencia e shërbimeve publike urbane	51,647,439	8,620,280	151,372,524				
5	Klubi shume sportesh Elbasan	32,212,784	5,376,571	32,493,761			1,500,000	80,000
6	Qendra ekonomike arsimit	412,776,683	68,920,137	96,657,519				2,204,900
7	Qendra sociale balashe	36,453,760	5,900,657	15,432,031				30,000
8	Agjencia e kulturës dhe turizmit	33,716,717	5,615,122	6,927,236				80,000
9	Njësia administrimit banesave sociale	2,887,396	478,851	37,503				40,000
10	Qendra artit Elbasan	24,759,300	4,316,377	36,854,484				
11	Bilanci I Konsoliduar	1,175,910,670	196,073,416	815,362,993	2,729,000	3,075,575	53,050,932	2,143,270,273

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Nga të dhënat e njësive shpenzuese për shpenzimet buxhetore të realizuara të dhëna referuar thesarit për regjistrimin e shpenzimeve individuale buxhetore u konstatua që totali i shpenzimeve sipas njësive individuale janë në vlerën; 1,175,910,670 lekë për llogarinë 600 “Paga dhe detyrime të punonjësve”; 196,073,416 lekë për llogarinë 601 “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore”; 815,362,993 lekë për llogarinë 602 “Blerje mallra dhe shërbime”; 2,729,000 lekë për llogarinë 603 “Subvencione”, 3,075,575 lekë për llogarinë 65 “Shpenzime financiare” për interesat e kredisë; 53,050,932 lekë për llogarinë 604 “Transferime korrente të brendshme” dhe 2,143,270,273 lekë për llogarinë 606 “Transferta për buxhet familjare dhe individë”.

Totali i shpenzimeve korente sipas thesarit janë në vlerën 4,389,472,859 lekë.(

1,175,910,670+196,073,416+815,362,993+2,729,000+3,075,575+53,050,932+2,143,270,273)

Për sa më sipër në të pasqyruara në pasqyren e Flukseve monetare Cash Flow të pasqyrës të konsoliduar janë pasqyruar shpenzime korente 4,409,383,413 lekë dhe duhej të pasqyroheshin në vlerën 4,389,472,859 lekë ose janë pasqyruar shpenzime më shumë 19,910,554 lekë (4,409,383,413 lekë - 4,389,472,859 lekë)

Shpenzime për principalin llogaria 166 jane realizuar 61,912,415 lekë.

Shpenzime buxhetore për llogarinë 230-231 janë në vlerën 659,750,998 lekë të detajuara si më poshtë vijon.

Tabela nr. 50: Të dhëna për shpenzimet buxhetore për llogarinë 230-231/lekë.

Nr.	Emërtimi I institucionit	231 Pagesa për detyrime e investime nga vitet e kaluara /cash Flow	231 Për detyrime e Investime te viti ushtrimor/cash Flow	Totali
1	Bashkia Qender Elbasan	39,437,359	359,692,739	399,130,098
1	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit		37,490,807	37,490,807
2	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	73,437,726	76,868,166	150,305,892
3	Agjencia e shërbimeve publike urbane		8,556,316	8,556,316
4	Klubi shume sportesh Elbasan		1,937,736	1,937,736
5	Qendra ekonomike arsimit		54,485,473	54,485,473
6	Qendra sociale balashe		1,194,720	1,194,720
7	Agjencia e kulturës dhe turizmit		6,649,956	6,649,956
8	Njësia administrimit banesave sociale			-
9	Qendra artit Elbasan		-	-
	Totali njësite e varësisë	112,875,085	546,875,913	659,750,998

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Në total shpenzime buxhetore për klasën 6 llogaria 230-231 dhe llogaria 166 principali janë realizuar në vlerën 5,111,136,012 lekë (4,389,472,859 lekë + 659,750,998 lekë + 61,912,415 lekë).

Nga auditimi i pasqyrës së Flukseve monetare Cash Flow u konstatua që janë paraqitur akordime fondesh në total 6,952,343,635 lekë nga të cilat; akordim fonde buxhetore për shpenzime korente /Cash Flow në vlerën **5,232,315,869 lekë**, arkëtime e të hyra (cash), gjatë vitit ushtrimor/cash Flow 1,207,879,100 lekë dhe akordim fonde buxhetore për shpenzime kapitale /Cash Flow në vlerën 512,148,666 lekë. Të detajuara paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela nr. 51: Të dhëna për akordime fondesh në total/lekë.

Nr	Emertimi I institucionit	Akordim fonde buxhetore per shpenzime korente /Cash Flow	Arketime e te hyra (cash), gjate vitit ushtrimor/cash Flow	Akordim fonde buxhetore per shpenzime Kapitale /Cash Flow	Totali i te hyrave
1	Bashkia Elbasan qendër	3,830,122,742	1,121,322,713	170,822,689	5,122,268,144
2	Agjencia e pyjeve, bujqësisë dhe mjedisit	71,620,283	30,223,898	26,634,933	128,479,114
3	Agjencia e shërbimeve publike Elbasan	235,586,576	3,557,059	151,123,827	390,267,462
4	Agjencia e shërbimeve publike urbane	211,486,000	11,216,900	39,486,594	262,189,494
5	Klubi shume sportesh Elbasan	71,181,779	1,261,776	2,016,800	74,460,355
6	Qendra ekonomike arsimit	635,956,263	37,659,812	110,453,018	784,069,093
7	Qendra sociale balashe	59,519,226	1,446,442	1,450,000	62,415,668
8	Agjencia e kulturës dhe turizmit	47,510,000		9,973,336	57,483,336
9	Njësia administrimit banesave sociale	4,110,000.00	200,000.00		4,310,000
10	Qendra artit Elbasan	65,223,000	990,500	187,469	66,400,969
11	Bilanci I Konsoliduar	5,232,315,869	1,207,879,100	512,148,666	6,952,343,635

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Në total akordime fondesh janë parqitur në pasqyrën e konsoliduar në vlerën 6,952,343,635 lekë Njësitë e varësisë fondet që delegohen nga Bashkia Elbasan qendër i paraqesin si akordim fondesh

buxhetore rrjedhimisht transferimi i fondeve nga Bashkia qendër në njësité e varësisë për vlerën 1,544,776,901 lekë është dubluar si akordim fondesh duke sjellë pasaktësi në paraqitjen e flukseve monetare cash Flow dhe duke mos dhënë siguri për pasqyrimin e tyre në këtë pasqyrë.

Konkluzion: Totali i shpenzimeve korente sipas thesarit janë në vlerën 4,389,472,859 lekë (1,175,910,670+196,073,416+815,362,993+2,729,000+3,075,575+53,050,932+2,143,270,273)

Të pasqyruara në pasqyren e Flukseve monetare Cash Flow të pasqyrës të konsoliduar janë pasqyruar shpenzime korente 4,409,383,413 lekë dhe duhej të pasqyroheshin në vlerën 4,389,472,859 lekë ose janë pasqyruar shpenzime më shumë 19,910,554 lekë (4,409,383,413 lekë - 4,389,472,859 lekë).

Transferimi i fondeve nga Bashkia qendër në njësité e varësisë për vlerën 1,544,776,901 lekë është dubluar si akordim fondesh në bilancin e konsoliduar duke sjellë pasaktësi në paraqitjen e flukseve monetare Cash Flow dhe duke mos dhënë siguri për pasqyrimin e tyre në këtë pasqyrë.

Këto veprime janë në papajtueshmëri me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar ,neni 22, pika 3, germa “dh”.

Në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 ‘Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësité e qeverisjes së përgjithshme’ pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39.

“Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësité e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 39 ndryshon përmbajtjen, si më poshtë: Këto pasqyra iu dërgohen njësive të qeverisjes së përgjithshme të Juridiksionit përkatës të degëve të thesarit për krahasimin e bilancit vërtetues me informacionin financiar të SIFQ, rakorduar gjatë vitit sipas paragrafit 37. Qëllimi kryesor është përgatitja e pasqyrave financiare Individuale për çdo njësi shpenzuese, përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara në nivel njësie publike qendrore ose vendore, së bashku me shënimet shpjeguese, ku analizohet diferenca midis vlerave kontabël të njësive dhe vlerave kontabël të SIFQ, veçanërisht diferenca midis zërave të Pasqyrës së Flukseve Monetare prodhuar nga SIFQ dhe zërat e Pasqyrës së Performancës Financiare prodhuar nga njësité e qeverisjes së përgjithshme”.

Për veprimet dhe mosveprimet më sipër mban përgjegjësi :

Znj. A. M., Nepunes zbatues Bashkia Elbasan.

• **Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:**

- **Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës:**

Nga verifikimi me zgjedhje i periudhave Janar, Mars, Dhjetor 2024 në lidhje me transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës konstatohet se: Transaksionet janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj.. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

- **Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet arkës:**

Nga verifikimi me zgjedhje i periudhave Janar, Mars, Dhjetor 2024 në lidhje me veprimet me arkë konstatohet se:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet arkës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e arkës në bazë të arkëtimeve dhe pagesave të kryera nga Bashkia Elbasan(qendër). Për arkëtimet dhe pagesat është mbajtur libri dhe ditari i arkës. Dokumentet e përdorura për arkëtime(mandat arkëtime) janë me numër serial dhe të firmosura nga arkëtari dhe N/zbatues.

Nga verifikimi u konstatua se transaksionet financiare të kryera nëpërmjet arkës **të ardhurat e arkës nuk derdhen çdo ditë në bankë**. Kjo praktikë bie ndesh me kërkesat e kuadrit rregullator për administrimin e fondeve publike, i cili parashikon që mjetet monetare të arkës të depozitohen në bankë brenda ditës ose ditën pasardhëse të punës, me qëllim minimizimin e riskut të humbjes, abuzimit apo përdorimit të paautorizuar të mjeteve.

Për periudhën e përzgjedhur për auditim rezulton se; për muajin Janar në **5 raste** arkëtimet në arkë janë në vlera më të mëdha se 1,000 lekë, arkëtime për taksa vendore; për muajin Mars në **18 raste** arkëtimet në arkë janë në vlera të mëdha se 1,000 lekë , arkëtime për derdhje tregu ambulant, taksa vendore dhe bileta tregu; për muajin Dhjetor 2024 në **28 raste** arkëtimet në arkë janë në vlera të mëdha se 1,000 lekë arkëtime për bonus strehimi , taksa vendore dhe pulla.

Këto veprime janë në kundërshtim me *Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, pika 62. Veprim arke është shërbimi i arkëtimin dhe i pagesës me para në dorë që bëhet në të gjitha nivelet e njesise publike, në bazë të mandatarkëtimin ose të mandatpagesës. 63. Veprimet me para ne dore kryhen vetem brenda limitit ditor te arkes, te miratuar nga Nepunesi i Pare Autorizues me propozim te Sistemit te Thesarit, me akte te vecanta sipas specifikave te njesive publike.*

64. *Veprimet me para në dorë kryhen për transaksionet financiare në formën e paradhënies për udhëtime e dieta, gjithashtu edhe për arkëtimin e të ardhurave në vlera më të vogla se 1000 lekë.*

në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.9 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pika 212, ku citohet:

Për arkëtimet mbi 1000 lekë, njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të operojnë nëpërmjet sistemit bankar ose shërbimit postar (në bazë të një marrëveshjeje të njërive të qeverisjes së përgjithshme me postën shqiptare). Përbashkëtim nga ky rregull bëjnë vetëm arkëtimet e tarifave për shërbimin shëndetësor ofruar pacientëve nga njësitë shpenzuese të shërbimit shëndetësor.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet arkës (arkëtime) me vlerë mbi 1,000 lekë për periudhën e përzgjedhur Janar, Mars, Dhjetor 2024 paraqiten në aneksin 1/48, bashkangjitur këtij raporti auditimi.

- **Veprimet nëpërmjet magazinës**

Nga auditimi u konstatua se në Bashkinë Elbasan, mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhet në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhet sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë. Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara. Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve.

- **Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj, për Bashkinë Elbasan).**

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar, Mars dhe Dhjetor 2024) dhe konstatohet se

ato plotësohen sipas rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore. Është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Elbasan, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Elbasan, është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 123/1, datë 19.12.2023, i ndryshuar.

Sipas listë pagesave të muajve (Janar, Mars dhe Dhjetor 2024) konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës znj. A. M. dhe nga zv.Kryetari Bashkisë znj A. B.. Tabela e burimit të Financimit të pagave paraqitet e detajuar në aneksin 1/49, bashkangjitur këtij raporti auditimi.

Realizimi i fondit të pagave rezulton 94%, sigurimeve shoqërore 92% dhe fondit të veçantë 100%. Të dhëna të detajuara paraqitet në aneksin 1/50, bashkangjitur këtij raporti auditimi.

IV- GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me afatin e hartimit të pasqyrave financiare të konsoliduar u konstatua që pasqyra financiare e konsoliduar është dërguar në degën e thesarit me shkresën nr.4332.Prot., datë 04.09.2025, jashtë afatit, që është muaji Prill, të përcaktuar në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar Kreu pika 122. (Më hollësisht trajtuar në faqe 14 - 15 të Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan të marrë masa për hartimin në afat të pasqyrave financiare të konsoliduar.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve u konstatua se njësia shpenzuese Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale ka bërë vlerësimin për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimit nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, por nuk ka ngritur komisionin për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e aktiveve. Vlerat e aktiveve me kosto historike në proces verbalet e vlerësimit sipas llogarive përkatëse janë; llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 366,204 lekë; llogaria 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 460,077 lekë; llogaria 215 “Mjete transporti” në vlerën 19,003,625 lekë; llogaria 327 “Inventar i imët” në vlerën 3,218,066 lekë. Nga ana e sektorit të financës është bërë shkarkimi nga kartelat e llogarive përkatëse bazuar në proces verbalet e komisionit të vlerësimit dhe vlera e llogarisë 215 “Mjete transporti” prej 19,003,625 lekë nuk është kaluar në llogarinë 24 “Aktive të dëmtuara”.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar neni 8 germa (ç) neni 9 germa (ë) dhe UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 96 dhe pika 109. (Më hollësisht trajtuar në faqe 16-18 të Raportit të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale në cilësinë e nëpunësit autorizues të marrë masa për ngritjen e komisionit të asgjësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve, gjithashtu sektori i financës vlerën e aktiveve të llogarisë 215 “Mjete transporti” prej 19,003,625 lekë ta kontabilizojë në llogarinë 24 “Aktive të dëmtuara” deri në asgjësimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të pasqyruara në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrës të konsoliduar u konstatua që llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar” është paraqitur në vlerën 489,849,456 lekë, ndërsa sipas akt rakordimeve me thesarin për të ardhurat e trashëguara për vitin 2025 të bashkisë qendër dhe njërive shpenzuese u konstatua që të ardhurat e trashëguara janë në vlerën 457,784,864 lekë ose janë pasqyruar më shumë në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrës së konsoliduar në vlerën 32,064,592 lekë.

- Bashkia qendër Elbasan ka paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitit 2024 në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar” më shumë vlerën prej 10,759,053 lekë (446,759,542–436,000,489) se akt rakordimi me thesarin për të ardhurat që trashëgohen në vitin 2025.

- Agjencia e Pyjeve, Bujqësisë dhe Mjedisit ka paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitit 2024 në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar” më shumë vlerën prej 45,275 lekë (8,672,298 – 8,627,023) se akt rakordimi me thesarin për të ardhurat që trashëgohen në vitin 2025.

- Agjencia e Shërbimeve Publike Elbasan ka paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitit 2024 në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar” më shumë vlerën prej 5,620,638 lekë (6,043,880–423,242) se akt rakordimi me thesarin për të ardhurat që trashëgohen në vitin 2025.

- Qendra Ekonomike e Arsimit ka paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të vitit 2024 në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar” më shumë vlerën prej 15,639,626 lekë (20,432,290 - 4,792,664) se akt rakordimi me thesarin për të ardhurat që trashëgohen në vitin 2025.

Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit nuk na u vunë në dispozicion akt rakordimi i mbajtur me thesarin për llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, për bashkinë, e paraqitur në pasqyra financiare në vlerën 53,848,966 lekë, duke mos dhënë siguri për saktësinë e paraqitjes së llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar” në pasqyrat financiare të konsoliduar.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39 dhe pika 50.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 19- 22 të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtorja e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan së bashku me njësitë e varësisë të marrin masa të saktësojnë llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar” për diferencën në vlerën 32,064,592 lekë të paraqitur më shumë se akt rakordimi me thesarin dhe ta paraqesë saktë atë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Gjithashtu Drejtorja e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan së bashku me njësitë e varësisë të marrin masa të saktësojnë llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duke kryer rakordimin përkatës me thesarin për këtë llogari.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës së pozicionit financiar sipas pasqyrës së konsoliduar me të dhënat e llogarive sipas njësive shpenzuese u konstatua që llogaria 470 “*Llogari në pritje të ardhura për tu marrë*” + llogaria 4341 “*Operacione me shtetin detyrime*” është në vlerën 3,488,500 lekë. Llogaria 468 “*Debitor të ndryshëm*” është në vlerën 1,203,393,053 lekë. Llogaria 4341 “*Operacione me shtetin detyrime*” nuk kuadron me kundër partinë e saj llogarinë 468 “*Debitor të ndryshëm*” për vlerën 1,199,904,553 lekë (1,203,393,053 lekë - 3,488,500 lekë). Llogaria 4341 “*Operacione me shtetin detyrime*” është nënvlerësuar në paraqitjen e saj në pozicionin financiar të pasqyrës së konsoliduar për vlerën 1,199,904,553 lekë. Nga analiza e kryer rezulton se kemi të bëjmë me një keq klasifikim pasi vlera është pasqyruar në llogarinë 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” është paraqitur si kundër parti e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese i ndryshuar pika 7 germa c, pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39. “*Seksioni 3.1*”. (Më hollësisht trajtuar në faqe 45-47 të Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan së bashku me njësitë e varësisë të marrin masa të saktësojnë llogarinë 4341 “*Operacione me shtetin detyrime*” e cila është nënvlerësuar në paraqitjen e saj në pozicionin financiar të pasqyrës të konsoliduar për vlerën 1,199,904,553 lekë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës së pozicionit financiar sipas pasqyrës së konsoliduar rezultoi se llogaria 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” në datë 31.12.2024, është pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrës të konsoliduar në vlerën është 18,480,336 lekë, ndërsa sipas të dhënave të thesarit është në vlerën 89,099,262 lekë me një diferencë prej 70,618,926 lekë e regjistruar më shumë në thesar se në pasqyrat e pozicionit financiar.

Nga krahasimi i të dhënave të pasqyrave financiare të pozicionit financiar të njësive shpenzuese u konstatua që Agjencia e Shërbimeve Publike Elbasan gjendjen e llogarisë 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” sipas pasqyrës së pozicionit financiar e ka në vlerën prej 2,818,800 lekë, ndërsa sipas të dhënave të thesarit për pozicionin financiar të llogarive është në vlerën 73,437,726 lekë ose është regjistruar në thesar më shumë për vlerën 70,618,926 lekë.

Regjistrimet e thesarit në llogarinë 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” nuk janë pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar që prodhohet nga SIFQ në nivel njësie shpenzuese, ose njësie publike qendrore ose vendore për efekte rakordimi me këto të fundit. Pasqyrimi në këtë llogari i vlerave kryhet vetëm për shpenzimet e parapaguara rrjedhimisht paraqitja e saj në vlerën 18,480,336 lekë është e pasaktë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar ,neni 22, pika 3, germa “dh” dhe me Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar pika 15 Seksioni 3.1, Paragrafi 39 dhe 42.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 26- 27 të Raportit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në bashkëpunim me njësitë e varësisë të marrin

masa për pasqyrimin e saktë të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” duke pasqyruar në këtë llogari vetëm për shpenzimet e parapaguara. Pas saktësisimit të kësaj llogarie të marrin masa për rakordimin e saj me thesarin.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” sipas pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduar u konstatua se, 14 projekte, në vlerën 41,908,063 lekë (kosto historike), që janë të përfshirë në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, janë të pa analizuar sipas investimeve që u përkasin dhe për 45 projekte në vlerën 127,030,496 lekë nuk ka informacion në lidhje me përfundimin e objekteve.

Kjo ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. Kreu II, Aneksi, pika 2, klasa 2, pika 5 dhe pika 2.1. (Më hollësisht trajtuar në faqe 27- 28 të Raportit të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masa të identifikojë 14 projektet në vlerën 41,908,063 lekë (kosto historike), se cilit investim i përkasin dhe të saktësojë nëse investimet që u përkasin 45 projektet në vlerën 127,030,496 lekë janë kryer apo jo. Sipas përkatësisë së projekteve, për objektet e përfunduara, të marrë masa për kapitalizmin e tyre në shtesa të llogarive përkatëse të aktiveve.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi saktësinë e llogarisë 210 “Toka, troje terrene” rezultoi se kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2024. Në këtë llogari janë të evidentuar 38 objekte në vlerën 547,679,883 lekë, nga të cilat vetëm për një objekt është përcaktuar sipërfaqja dhe konkretisht, “Toke varreza publike në sipërfaqen 6130 m2 në vlerën 4,069,958 lekë”. Kjo llogari në 37 raste në vlerën 543,609,925 lekë përbëhet nga toka troje e terrene që janë kryesisht shpronësime që janë të paraqitura vetëm në vlerën e shpronësimit, të pa analizuar sipas sipërfaqeve të tyre dhe në katër raste, në vlerën 60,835,633 lekë, janë të pa analizuar edhe për llojin e shpronësimit. Nga verifikimi dhe analiza e Llogarisë. 210 “Toka, troje, terrene”, u konstatua se nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit asnjë prej; a) trojeve nën objekt për ndërtesat e shkollave që ka në administrim, ndërtesat e shkollave dhe të zyrave në Nj. A, etj., sipas regjistrimit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”; b)-truallit të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë; c) trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Elbasan, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

- Nga auditimi mbi saktësinë e Llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” u konstatua se, në këtë llogari janë të evidentuar 24 objekte në vlerën 58,750,001 lekë, ku për asnjë objekt nuk është përcaktuar sipërfaqja që i përket. Kjo llogari në 19 raste në vlerën 30,368,356 lekë ka të pasqyruar pemë dekorative, lulishte, vazo betoni dhe drurë frutorë të llojeve të ndryshëm që jo në të gjitha rastet janë të analizuar,

por në përgjithësi janë të paraqitura vetëm në vlerë. (Më hollësisht trajtuar në faqe 28- 31 të Raportit të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Nëpunësi autorizues në bashkëpunim me nëpunësin zbatues të Bashkisë Elbasan dhe njësisë të vartësisë të marrin masa për monitorimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive të komisioneve të inventarizimit në kryerjen e procedurave të verifikimit dhe identifikimit të pronave të Bashkisë Elbasan për llogarinë (210)“*Toka, troje terrene*” dhe për llogarinë 211 “*Pyje Plantacione*” në lidhje me gjendjen fizike të tyre, si dhe hartimin e regjistrimit fizik të aktiveve që bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se llogaria 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” në fund të vitit 2024 paraqitet me vlerë historike 3,406,146,786 lekë dhe me vlerë neto paraqitet në vlerën 2,342,162,504 lekë. Në llogarinë 212 “*Ndërtime e konstruksione*”, Bashkia Elbasan ka të evidentuar një numër të konsiderueshëm objektesh të cilat janë të pa analizuara.

- Llogaria 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në fund të vitit 2024 paraqitet me vlerë historike 8,414,789,969 lekë dhe me vlerë neto, paraqitet në vlerën 4,450,996,545 lekë.

Në inventarin e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” rezultojnë 33 objekte në vlerën 516,441,467 lekë, të cilat janë asete të ujësjellësit. Nga auditimi i dokumentacionit dhe nga të dhënat e vëna në dispozicion u konstatua se, për 78 objekte pasqyrimi në llogarinë 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*” është bërë në vlerën zero lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, Kreu III, pika 30.

(Më hollësisht trajtuar në faqe 31- 34 të Raportit të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Elbasan të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për kryerjen e procedurave për verifikimin, identifikimin e pronave të bashkisë për llogarinë 212 “*Ndërtime e konstruksione*” dhe llogarinë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, mbi gjendjen fizike për hartimin e regjistrimit fizik të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për transferimin e 33 objekteve në vlerën 516,441,467 lekë, të cilat janë asete të ujësjellësit, në “*Sh.R. U. K. E. Sha*” me NIPT M...V, duke njoftuar Këshillin Bashkiak për procesin e transferimit të këtyre aktiveve.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të pasqyrave individuale të njësisë shpenzuese të krahasuara me të dhënat e thesarit u konstatua se:

- Llogaria 42 “*Detyrime ndaj personelit*” sipas bilancit të konsoliduar është në vlerën 91,547,388 lekë dhe sipas të dhënave të thesarit për njësitë individuale është në vlerën 89,032,827 lekë. Konstatohet diferencë në raportim krahasuar me thesarin nga Agjencia e Kulturës dhe Turizmit për vlerën prej 2,514,561 lekë, ku sipas pasqyrës së pozicionit financiar është në vlerën 2,514,561 lekë, ndërsa sipas

thesarit zero lekë.

- Llogaria 431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*” sipas bilancit të konsoliduar është në vlerën 8,092,567 lekë dhe sipas thesarit individuale është 7,851,972 lekë. Konstatohet diferencë në raportim krahasuar me thesarin nga Agjencia e Kulturës dhe Turizmit në vlerën 240,595 lekë, ku sipas pasqyrës së pozicionit financiar është në vlerën 240,595 lekë, ndërsa sipas thesarit zero lekë.

- Llogaria 435 “*Sigurime shoqërore*” sipas bilancit të konsoliduar është në vlerën 27,923,709 lekë dhe sipas të dhënave të thesarit për njësitë individuale është në vlerën 27,163,559 lekë. Konstatohet diferencë në raportim krahasuar me thesarin nga Agjencia e Kulturës dhe Turizmit për vlerën prej 760,150 lekë, ku sipas pasqyrës së pozicionit financiar është në vlerën 760,150 lekë, ndërsa sipas thesarit është zero lekë.

- Llogaria 436 “*Sigurime shëndetësore*” sipas bilancit të konsoliduar është në vlerën 3,569,469 lekë dhe sipas të dhënave të thesarit është në vlerën 3,463,979 lekë. Konstatohet diferencë në raportim krahasuar me thesarin nga Agjencia e Kulturës dhe Turizmit për vlerën prej 105,490 lekë, ku sipas pasqyrës së pozicionit financiar është në vlerën 105,490 lekë ndërsa sipas thesarit është zero lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, neni 22, pika 3, germa “dh”.

Në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39 dhe pika 50. (Më hollësisht trajtuar në faqe 42- 44 të Raportit të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan së bashku me njësitë e varësisë të marrin masa të saktësojnë llogaritë individuale të pasqyrave financiare, duke kryer rakordimin përkatës me thesarin për këto llogari.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se llogaria 230-231 “*Investime*” në fillim të vitit 2024 rezulton në vlerën 538,003,598 lekë dhe në fund të vitit 2024 rezulton në vlerën 439,658,665 lekë ose me një pakësim gjatë vitit 2024 për vlerën prej 98,344,933 lekë. Blerjet e kryera me pagesë sipas pasqyrës formati 7/a “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*” të pasqyrës të konsoliduar janë në vlerën 758,182,195 leke dhe nuk përputhen me shumën e pakësimit të llogarisë 230-231 nga viti i kaluar që është në vlerën 98,344,933 lekë plus 659,750,998 lekë që është pasqyruar në pasqyrën e flukseve monetare Cash Flow Formatit nr.3. Mospërputhja është në vlerën 86,264 lekë (758,182,195 – 659,750,998 - 98,344,933).

Nga auditimi i kryer në lidhje me lëvizjen e kësaj llogarie u konstatua se:

Vlera kreditore e llogarisë 230-231 “*Investime*” e pasqyruar në kontabilitet në shumën 758,182,195 lekë nuk përputhet me pasqyrimin në Formatin F6 “*Investimet*” që është në vlerën 750,337,519 lekë, për vlerën 7,844,676 lekë (758,182,195-750,337,519), pasi kjo vlerë është pasqyruar me pak në Formatin F6 “*Investimet*”.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, pika 2.1, germa b dhe germa d. (Më hollësisht trajtuar në faqe 38- 39 të Raportit të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan të marrë masa të saktësojë

mospërputhjen e llogarisë 230-231 “Investime” për vlerën 7,844,676 lekë midis pasqyrimin të saj në kontabilitet krahasuar me pasqyrën e Formatit F6 “Investimet”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se llogaria 16,17,18 “Huat afat gjata” në fund të vitit 2024, paraqitet në vlerën 15,439,499 lekë. Nga auditimi i pasqyrave individuale sipas pozicionit financiar të thesarit u konstatua se:

- Njësia e Administrimit të Banesave Sociale ka të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar sipas thesarit vlerën prej minus 126,056,789 lekë, ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrës individuale kjo vlerë është zero lekë ose e regjistruar në thesar më pak për vlerën 126,056,789 lekë.

Në tërësi nga të dhënat e pasqyrave individuale të pozicionit financiar krahasuar me të dhënat e llogarive të pozicionit financiar sipas thesarit rezultojnë të regjistruara më pak në thesar llogaria 16,17,18 “Huat afat gjata” për vlerën 110,617,290 lekë. Vlera negative prej 110,617,290 lekë e huave nuk paraqet një vlerë të saktë dhe të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar të pasqyrës së konsoliduar.

Nga auditimi i pasqyrës së performancës së pasqyrave të konsoliduar të Bashkisë Elbasan u konstatua që në llogarinë 650 “Interesa për bono thesarit dhe kredi direkte” janë pasqyruar pagesa e principalit të kredisë për njësinë shpenzuese Bashkia Elbasan në vlerën 50,572,025 lekë, që nuk duheshin pasqyruar si shpenzime pasi pagesa e principalit të kredisë nuk regjistrohet si shpenzim në pasqyrën e performancës financiare por duhet të regjistrohet si pakësim detyrimi ndaj huadhënësve rrjedhimisht pakësim i llogarisë 16,17,18 “Huat afat gjata” të pasivit të pasqyrës së pozicionit financiar. Pasqyrimi në shpenzime i vlerës 50,572,025 lekë ka pakësuar llogarinë 85 “Rezultatit i veprimtarisë ushtrimore” për vitin 2024 në vlerën 50,572,025 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar pika 3.3. pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39 dhe pika 50 dhe Aneksi 1, pika 1.1.6 Grupi i Llogarive 16 “Bono thesari dhe huamarrje e brendshme” dhe grupi 17 “Huamarrje e huaj”. (Më hollësisht trajtuar në faqe 49- 51 të Raportit të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan së bashku me njësinë e varësisë Njësia e Administrimit të Banesave Sociale të marrin masa të saktësojnë llogaritë 16,17,18 “Huat afat gjata” të pasqyrave financiare, duke kryer rakordimin përkatës me thesarin për këtë llogari.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

11.2. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan të marrë masa të saktësojë llogarinë 650 “Interesa për bono thesarit dhe kredi direkte” në të cilën është pasqyruar pagesa e principalit të kredisë për njësinë shpenzuese Bashkia Elbasan për vlerën 50,572,025 lekë dhe pasqyrimin e saj në pakësimin e llogarisë 16,17,18 “Huat afat gjata”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së performancës të pasqyrës së konsoliduar u konstatua se:

- Të ardhura për vitin 2024 janë paraqitur në vlerën 6,559,439,880 lekë, ndërsa vetëm të ardhurat në pasqyrën e performancës të Bashkisë Qendër Elbasan janë paraqitur në vlerën 5,160,516,808 lekë. Bashkia Qendër Elbasan ka transferuar 1,544,776,902 lekë të njësitë e varësisë nëpërmjet llogarisë 6040 (6040/1) “Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë”. Nga auditimi i pasqyrave të performancës financiare individuale të njëjësive të varësisë u konstatua që njësitë e varësisë kanë raportuar të ardhura

në vlerën 1,398,923,072 lekë, nga të cilat në vlerën 87,501,115 lekë janë të ardhura të veta të krijuara nga njësitë e varësisë. Të ardhurat që duheshin raportuar në pasqyrën e performancës të pasqyrës së konsoliduar janë në vlerën 5,160,516,808 lekë të Bashkisë Qendër Elbasan plus të ardhurat e veta të njërive shpenzuese për shumën prej 87,501,115 lekë. Totali që duhej raportuar si e ardhur në pasqyrën e performancës së pasqyrës të konsoliduar është në vlerën 5,248,017,923 lekë (5,160,516,808 lekë + 87,501,115 lekë).

Në pasqyrën e performancës financiare të pasqyrës së konsoliduar janë paraqitur të ardhura më shumë në vlerën 1,311,421,957 lekë (6,559,439,880-5,248,017,923).

- Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës së performancës së pasqyrës së konsoliduar u konstatua që janë paraqitur shpenzime në vlerën 6,171,047,024 lekë dhe duheshin paraqitur në vlerën 4,797,203,195 lekë (6,171,047,024 - 1,373,843,829), duke u mbivlerësuar në shumën 1,373,843,829 lekë, kjo ka sjellë dublimin e shpenzimeve të njërive të varësisë duke qene që janë regjistruar këto shpenzime edhe te llogaria 604 “*Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë*” të pasqyrave financiare të bashkisë Qendër Elbasan dhe si shpenzime të njërive të varësisë në pasqyrën e konsoliduar.

Llogaria 85 “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore/ Teprica e periudhës*” duhej paraqitur në vlerën 450,814,728 lekë dhe është paraqitur 388,392,856 lekë dhe është nënvlerësuar për vlerën 62,421,872 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar pika 4.1. dhe pika 4.2. (Më hollësisht trajtuar në faqe 53 - 68 të Raportit të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan të marrë masa të saktësojë të ardhurat dhe shpenzimet e raportuara në pasqyrën e performancës financiare të bilancit të konsoliduar, duke pasqyruar saktë të ardhurat dhe shpenzimet korente të vitit ushtrimor për të shmangur dublimin e tyre dhe pasqyrimin e drejtë të llogarisë 85 “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore/ Teprica e periudhës*”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare u konstatua se:

- Ka pasaktësi në paraqitjen e të ardhurave sipas llojit të tyre në vlerën 14,127,000 lekë që janë pasqyruar më pak të ardhura pasi nuk është paraqitur si e ardhur “*Të ardhura nga shitja aksione futbollit*” në vlerën 14,127,000 lekë.

- Llogaria 603 “*Subvencionet*” është paraqitur në vlerën 5,173,000 lekë dhe duhej të pasqyrohej në vlerën 2,729,000 lekë. Konstatohet që janë pasqyruar më shume shpenzime në këtë llogari për vlerën 2,444,000 lekë duke ndikuar në llogarinë 85 “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*” dhe nënvlerësuar këtë llogari për vlerën 2,444,000 lekë.

- Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare të pasqyrës të konsoliduar u konstatua që në llogarinë 6040 (6040/2) “*Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë*” është paraqitur vlera 37,496,947 lekë që përfaqëson pagesa për fatkeqësi natyrore dhe pagesa për investime. Në këtë nën llogari janë paraqitur shpenzime për investime në objekte në vlerën 19,089,830 lekë të cilat nuk duhej të paraqiteshin në këtë nën llogari pasi nuk janë shpenzime korente por shpenzime për investime kapitale. Për rrjedhojë janë pasqyruar më shumë shpenzime në këtë llogari për vlerën 19,089,830 lekë duke ndikuar në llogarinë 85 “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*” dhe nënvlerësuar këtë llogari për vlerën 19,089,830 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes,*

paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 4.1.me Udhëzimin nr.5 pika 12, seksioni 3.1 si dhe pika 14, seksioni 3.1 paragrafi 39. (Më hollësisht trajtuar në faqe 56 - 62 të Raportit të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan të marrë masa të saktësojë të ardhurat “*Të ardhura nga shitja aksione futbollit*” në vlerën 14,127,000 lekë të pa raportuara në pasqyrën e performancës financiare të pasqyrës të konsoliduar duke kryer rakordimin përkatës me degën e thesarit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

13.2. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan të marrë masa të saktësojë llogarinë 603 “*Subvencionet*” në pasqyrën e performancës financiare të bilancit të konsoliduar duke kryer rakordimin përkatës me degën e thesarit. Gjithashtu të marrë masa të saktësojë shpenzimet e raportuara në pasqyrën e performancës financiare të bilancit të konsoliduar duke shmangur dublimet e shpenzimeve në raportim.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës së performancës financiare u konstatua se llogaria 63 “*Ndryshimi i Gjendjes së Inventarit*” paraqitet në fund të vitit 2024 në pasqyrën e konsoliduar në vlerën minus 3,474,580 lekë. Nga rakordimi i pasqyrave të performancës financiare individuale sipas njërive shpenzuese me thesarin u konstatua që vlera e regjistruar në thesar për këtë llogari është në vlerën 26,482,221 lekë dhe nuk rakordon me thesarin për vlerën 29,956,801 lekë [26,482,221-(-3,474,580)]. Diferenca në rakordim paraqitet në njësinë shpenzuese Agjencia e Pyjeve, Bujqësisë dhe Mjedisit për vlerën 7,676,447 lekë dhe nga Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane në vlerën 22,280,354 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39. (Më hollësisht trajtuar në faqe 63 të Raportit të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan të marrë masa të saktësojë llogarinë 63 “*Ndryshimi i Gjendjes së Inventarit*” në pasqyrën e performancës financiare të bilancit të konsoliduar, duke kryer rakordimin përkatës me degën e thesarit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së e flukseve monetare Cash Flow u konstatua se fondet që delegohen nga Bashkia Elbasan qendër njësitë e varësisë i paraqesin si akordim fondesh buxhetore rrjedhimisht transferimi i fondeve nga Bashkia qendër në njësitë e varësisë për vlerën 1,544,776,901 lekë është dubluar si akordim fondesh duke sjellë pasaktësi në paraqitjen e flukseve monetare Cash Flow dhe duke mos dhënë siguri për pasqyrimin e tyre në këtë pasqyrë.

Totali i shpenzimeve korente të klasës 6 “*Shpenzime*” sipas thesarit është në vlerën 4,389,472,859 lekë. Të pasqyruara në pasqyrën e Flukseve monetare Cash Flow të pasqyrës të konsoliduar janë në vlerën 4,409,383,413 lekë dhe duhej të pasqyroheshin në vlerën 4,389,472,859 lekë ose janë pasqyruar shpenzime *më shumë në vlerën 19,910,554 lekë* (4,409,383,413 lekë - 4,389,472,859 lekë).

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave*

financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 14, Seksioni 3.1 paragrafi 39. (Më hollësisht trajtuar në faqe 66 - 69 të Raportit të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës e Bashkisë Elbasan të marrë masa të saktësojë akordimin e fondeve buxhetore si dhe shpenzimet buxhetore që pasqyrohen në pasqyrën e Flukseve monetare Cash Flow të bilancit të konsoliduar duke shmangur dublimin e tyre.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës 7/b në lidhje me zbatimin e normave të amortizimit u konstatua se:

- Amortizimi i llogaritur në njësinë shpenzuese ASHPR për llogarinë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” është pasqyruar në vlerën 159,371,144 lekë dhe duhej pasqyruar në vlerën 145,347,133 lekë, rrjedhimisht është llogaritur më tepër amortizim në vlerën 14,024,011 lekë (159,371,144 - 145,347,133) si pasojë e mos zbatimit të saktë të normave të amortizimit.

- Nga verifikimi i paraqitjes së vlerës së amortizimit të llogaritur në pasqyrat statistikore (Formati nr.7/b) në lidhje me pasqyrat financiare individuale të njërive shpenzuese u konstatua se nga ana e njësisë shpenzuese të ASHPU-së pasqyrimi i të dhënave në lidhje me amortizimin është bërë i pa saktë pasi nuk ka paraqitur në kolonën përkatëse koston historike të aktiveve në vlerën 3,017,317,557 lekë, amortizimin e akumuluar deri në datën 01.01.2024 në vlerën 1,415,643,423 lekë dhe amortizimin vjetor në vlerën 82,254,354 lekë për aktivet që janë transferuar nga ASHPR sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 100, datë 30.09.2024 “*Për miratimin e ndarjes së asetëve ndërmjet ASHPR dhe ASHPU*”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, Kreu II, pika 5 dhe Kreu III, pika 36. (Më hollësisht trajtuar në faqe 41 - 42 të Raportit të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në bashkëpunim me Sektorin e Financës në njësinë shpenzuese ASHPR të marrë masat të pasqyrojë saktë gjendjen dhe lëvizjet e llogarisë 213 “*Rruge, rrjete, vepra ujore*” në pasqyrën statistikore (Formati nr.7/b), si dhe të korrigjojë shumën e amortizimit të llogaritur më tepër në vlerën 14,024,011 lekë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRIKUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” rezultoi se kjo llogari paraqitet në fillim të vitit 2024 në shumën 1,178,076,762 lekë, ndërsa në fund të vitit 2024 në shumën prej 1,203,393,053 lekë. Gjatë vitit 2024 shtesa prej 25,316,291 lekë vjen si rezultat i rritjes së debitorëve për taksa e tarifa vendore të Bashkisë Elbasan dhe njërive të varësisë.

Nga auditimi i të dhënave që përmban llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” u konstatua se:

-Nuk janë përfshirë si debitorë në fund të vitit 2024 debitorët për gjobat e IMTV-së dhe nuk janë pasqyruar në kontabilitet detyrimet që kanë 21 subjekte në vlerën 52,656,555 lekë.

-Nuk janë kontabilizuar debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë të konstatuar nga auditimi i

mëparshëm i KLSH-së në vlerën 17,221,950 lekë dhe shtesa e debitorëve për vitin 2024, për 12 persona në vlerën 492,486 lekë. Totali i debitorëve për tu kontabilizuar për taksën e ndikimit në infrastrukturë është në vlerën 17,714,436 lekë (17,221,950 lekë + 492,486 lekë).

-Nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve nga kontratat e qirasë të fondit pyjor kullororë për katër subjekte në vlerën 12,368,615 lekë të konstatuara nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.

Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” në fund të vitit 2024 nuk paraqet pamjen reale në raportimin financiar të Bashkisë Elbasan. Rezultojnë të ardhura të munguara si pasojë e mos kontabilizimit të debitorëve për vlerën 82,739,606 lekë.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj, Rregullore e brendshme e funksionimit të Bashkia Elbasan, Kreu VI, neni 36, pika 2.3.

(*Më hollësisht trajtuar në faqe 23-24 të Raportit të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masa të kontabilizojë në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” debitorët e pa pasqyruar në kontabilitet.

- Debitorët nga kontrata e qirasë të fondit pyjor kullororë në vlerën totale prej 12,368,615 lekë;
- Debitorët për gjobat e IMTV-së që kanë 21 subjekte në vlerën 52.656.555 lekë;
- Debitorët për taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 17,714,436 lekë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

C. MASA DISIPLINORE

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”; shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 të Ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”; neni 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “*Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë*”, kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Elbasan të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si vijon:

“Vërejtje” për tre nëpunjësit, si më poshtë:

1. Znj. A. M., në cilësinë e nëpunësit zbatues në Bashkinë Elbasan.

2. Z. A. C., në cilësinë e nëpunësit autorizues në Agjencinë e Shërbimeve Publike Rurale.

3. Znj. B. D., në cilësinë e nëpunësit zbatues në Agjencinë e Shërbimeve Publike Rurale.

për parregullsitë dhe pasaktësitë e konstatuara në pasqyrat financiare në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar.

D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit pjesë e shërbimit civil, për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Elbasan, Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT